P L A T F O R M Ë

PËRKUJDESJA GJITHSHQIPTARE

~ GJOKË DABAJ ~

~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~

SHËNIM PËRKUJTUES: Këto ide unë i kam shtjelluar në librin tim "Strategjia e shqiptarëvet". Madje, krejt ai libër, i cili synon të jetë
~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~

një manifest kombëtar për shekullin XXI dhe për shekujt që vijnë, çon pikërisht te arsyeja që shqiptarët e kanë TË DOMOSDOSHËM krijimin e një INSTITUCIONI gjithshqiptar dhe që unë e kam emërtuar PËRKUJDESJA GJITHSHQIPTARE. Është arsye madhore, të cilën pjesa e mençur, pjesa racionale e shqiptarëvet, duhet ta analizojë me seriozitetin e duhur.

ARSYETIMI IM: Kombi shqiptar është aktualisht MË MIRË se në kohët e derisotme. Kjo shihet në një varg realitetesh. (Nuk po i numërojmë këtu këta realitete, sepse nuk është ky qëllimi.) Jemi MË MIRË, por NUK MUND TË THEMI SE JEMI MIRË. Të ndarë në 6 shtete, të shpërndarë në të gjithë Globin, me gjendje e ngjarje nga më të hidhurat, si këtu në Atdhe, ashtu edhe nëpër vende ku kemi mërguar! Mjafton ky fakt, për të konkluduar se NUK JEMI MIRË.

Mirëpo, alarmi më i madh vjen nga parashikimi i së ardhshmes. Jo ndonjë parashikim bestyt, por parashikim realist, mbështetur në ç'ka ndodhur dhe në ç'po ndodh, brenda nesh edhe rreth nesh.

Brenda nesh ka DISKORDANCA permanente dhe të rrëzikshme. (Nuk po i numërojmë, pasi secili shqiptar, i informuar dhe i kthjellët, është në gjendje që t'i shohë vetë.)

Në kombet rreth nesh po rriten nacionalizmat me përmbajtje SHOVINIZMI dhe NAZIZMI.

Në shtetet e Evropës dhe më gjërë, po shfaqen kriza ekonomike që sjellin zi të gjithanshme.

Krizat, nëse ecet në këtë rrugë "përmirësimesh" kozmetikë, do të sjellin prishje ekuilibrash në shkallë Evrope dhe në shkallë botërore. BE-ja, sot është, nesër, për fatin tonë të keq, mund të mos ekzistojë më. Mund të copëzohet, ose kushedi ç'mund t'i ndodhë tjetër.

Kushedi ç'formë mund të marrë nesër BE-ja! NATO-ja, sot ekziston, por nesër, për fatin tonë edhe më të keq, kushedi si mund të përfundojë.

Pikërisht për këto arsye e shumë të tjera, të cilat kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me ekzistencën tonë, ne shqiptarëvet na kërkohet të mendohemi SERIOZISHT. Të mendohemi TANI e jo kur të jetë tepër vonë.

Ndodhemi në një shkallë demokracie, të atillë që lejohen organizimet. Unë them që duhet ta shfrytëzojmë këtë kohë demokratike, sepse më vonë mund të pendohemi rëndë. Ta krijojmë INSTITUCIONIN tonë TË PËRKUJDESJES dhe, pastaj, në ardhshin ditë më të mira, aq më mirë, por, në ardhshin ditë më të këqia, asgjë nuk do t'i mbrojë shqiptarët më mirë se një i këtillë INSTITUCION i yni gjithpërfshirës.

Të huajt na COPËTUAN! Na COPËTUAN e na STËRCOPËTUAN! Tragjikisht na kanë COPËTUAR! Na kanë poshtëruar dhe na kanë masakruar! Pjesërisht, EDHE PËR FAJIN E PARAARDHËSVET TANË!

Ne, të sotmit, duhet të gjejmë mënyra PËR T'U BASHKUAR dhe për t'i parandaluar tragjeditë mbi fëmijët dhe mbi nipërit tanë të ardhshëm.

PARASHTRIMI SHKURTIMISHT: Përkujdesja Gjithshqiptare duhet të jetë një INSTITUCION, i cili të marrë përsipërpër për t'u përkujdesur për secilin shqiptar kudo që të ndodhet. Parimi filozofik është ky: Vetëm duke u përkujdesur për secilën pjesë të një tërësie, sigurohet ekzistenca e asaj tërësie.

Përkujdesja Gjithshqiptare, siç mund të vetëkuptohet, është INSTITUCION tejshtetëror, tejfetar dhe tejpartiak, që do të thotë se

kjo Përkujdesje përfshin brenda vetes të gjithë shqiptarët, në cilindo shtet që ndodhen, cilësdo fe që i përkasin dhe në cilëndo parti apo shoqatë që bëjnë pjesë.

Pra, Përkujdesja Gjithshqiptare është një INSTITUCION, jo MBI shtetet, jo MBI fetë, jo MBI partitë, jo MBI shoqatat, por që synon t'i ketë në gjirin e vet, si pjesëtarë të vetët, pa i penguar veprimtaritë e tyre në sferat ku bëjnë pjesë, të gjithë pushtetarët shqiptarë, që e duan dhe e pranojnë një të këtillë organizim, të gjithë fetarët dhe besimtarët e cilësdo fe, të gjithë partiakët e cilësdo parti dhe të gjithë pjesëtarët e cilësdo shoqatë. Fjala TË GJITHË, natyrisht, do kuptuar thjeshtë si DËSHIRË e si TENDENCË, sepse, në një të tillë organizëm, do të mund të të përfshihen VETËM ata shqiptarë që DËSHIROJNË. E unë jam i bindur se ata do të vinin gjithnjë duke u shtuar. (Nëse do të krijohej ky organizëm.)

Shtytja, nxitja, për të krijuar këtë INSTITUCION tonin, buron nga fakti që shqiptarët u janë nënshtruar në të kaluarën dhe vazhdojnë t'u nënshtrohen edhe në të tashmen, shumë rrëziqeve, që nga HUMBJA E IDENTITETIT deri te HUMBJA E JETËS, pa një arsye madhore. Është e vërtetë që ekzistojnë shumë shoqata e organizata patriotike, qoftë në Rep.e Shqipërisë e në Rep.e Kosovës etj, qoftë jashtë Atdheut, por gjithkush prej nesh mund të konstatojë që, që të gjitha këto janë të pamjaftueshme. Janë të pamjaftueshme dhe do të mbeten të pamjaftueshme, edhe sikur të 2-fishoheshin apo 3-fishoheshin, sa kohë që nuk ka një fije, një fill, për t'i bashkuar në një organizëm të vetëm gjithpërfshirës.

Miliona shqiptarë kanë nevojë për një përkujdesje, KONKRETE e TË PËRDITSHME, sepse KONKRETISHT dhe PËRDITË ndeshen me probleme të pafund: papunësia, varfëria, mosmarrëveshjet njëri me

tjetrin, pashkollësia, telashet me drejtësinë, gjaqet, mërgimi, sëmundjet, burgjet, mosshkuarjet mirë në familje, sherret, divorcet, jetimëria, vjedhjet, lypsaria, përdorimi i alkolit, përdorimi i drogavet, rrjetet e falsifikimevet, babëzia e korrupsionit, padrejtësitë nacionale… dhe prapë të tjerë dhe të tjerë probleme.

Kur themi probleme, nuk kemi parasysh vetëm të varfërit. Probleme kanë edhe të kamurit tanë, sado që dikush mund të thotë: "Kur të jem vetë mirë, s'kam nevojë për kurrfarë përkujdesjesh." Por nuk do harruar që, si të pasurit, edhe të varfërit, janë pjesë e së njëjtës bashkësi, e cila quhet KOMB dhe, që një komb të qëndrojë më këmbë, që ai të mos shpërbëhet e të mos shkërmoqet, të mos dekompozohet (kështu siç po ndodh me ne në ditët e sotme), është E DOMOSDOSHME që dikush të përkujdeset për secilin pjesëtar të tijin.



FORMAT BAZË TË ORGANIZIMIT: Përkujdesja Gjithshqiptare ka vetëm 2 organe: organin QENDROR dhe një numër sa më të madh organesh VENDORË.

I.Organi qendror quhet Kryesia Qendrore e Përkujdesjes Gjithshqiptare. Ajo përbëhet prej 9 anëtarësh.

1.KRYETARI, i cili drejton dhe koordinon krejt veprimtarinë e Institucionit. Është menduar që selia e tij të jetë në Prizren, sepse Prizreni është qyteti ku është krijuar Lidhja Shqiptare e Prizrenit, por edhe për arsye të tjera. Selia e Kryesisë, aty ku zhvillon veprimtarinë e vet kryetari, ka edhe administratën përkatëse, natyrisht, me rrogë.

2.NËNKRYETARI, i ngarkuar për punët me personalitetet e Kombit tonë të të gjitha sferave, si dhe për lidhjet miqësore me të huajt. Për nënkryetarin nuk është e detyrueshme ta ketë selinë në Prizren, por ai duhet të jetë një njeri shumë i aftë dhe duhet të lëvizë shumë, për të kontaktuar me njerëzit. Në përgjithësi, të gjithë anëtarët e Kryesisë, përveç kryetarit, kanë shumë për të udhëtuar, përndryshe, ata nuk do të mund kurrë ta kryejnë misionin e madh të Përkujdesjes.

3.ANËTARI I PARË, i ngarkuar për punët me konfesionet fetarë, me klerikët, me kryeklerikët. Natyrshëm, të gjithë klerikët shqiptarë duhet të jenë pjesëtarë të Pëkujdesjes Gjithshqiptare. Nga puna e tyre varet shumë vazhdimi apo mosvazhdimi i mirëkuptimit ndërkonfesional ndër ne. Ky anëtar i Kryesisë së Përkujdesjes sonë është mirë, madje duhet të vijë nga radhët e klerikëvet. Dhe duhet ditur që edhe në këtë fushë ka shumë për të bërë.

4.ANËTARI I DYTË, i ngarkuar për punët me mërgatën tonë të hershme: me arvanitët, me arbëreshët e Italisë, me arbëneshët e Zarës dhe me të tjerë, kudo që ata të ndodhen, në Greqi, në Itali, në Kroaci, apo nëpër vende të ndryshëm të Botës. Ky, zakonisht, është: ose arvanitas, ose arbëresh i Italisë apo i Zarës, por mund të jetë edhe nga të tjerë shqiptarë, me kusht që t'i njohë mirë komunitetet në fjalë.

5.ANËTARI I TRETË, i ngarkuar për punët me mërgatën tonë të 2 shekujvet të fundit. Edhe ky, doemos, duhet të zgjidhet nga të mërguarit, i përkushtuar, i ditur, por veçanërisht i aftë për t'i kryer punët tepër të vështira me mërgatën tonë disamilionëshe.

6.ANËTARI I KATËRT, i ngarkuar për punët me shqiptarët autoktonë në Rep.e Greqisë, në Rep.e Sërbisë dhe në Rep.e Malit të Zi. Ky do të jetë: ose nga çamët ortodoksë, ose nga Kosova Lindore, ose nga shqiptarët që jetojnë në "rripin" prej Çakorrit në Ulqin. Gjithsesi, me cilësi të larta organizuese, por edhe diplomatike.

7.ANËTARI I PESTË, i ngarkuar për punët me shqiptarët në Ish-Rep.Jug. të Maqedonisë. Selia e tij, në njërin prej qytetevet tanë të atjeshëm. Duhet të ketë kapacitetet e nevojshëm, jo për përçarje, por për të realizuar BASHKIMIN. Kur themi BASHKIMIN, është fjala në radhë të parë për shqiptarët që jetojnë atje.

8.ANËTARI I GJASHTË, i ngarkuar për punët me shqiptarët në Rep.e Kosovës. Selia në Prishtinë. Njeri që di dhe mund ta çojë Rep.e Kosovës, me rrugën më të shpejtë dhe më të sigurtë, në përmbushjen e amanetevet të atyre që kanë dhënë jetët për atë Kosovë. Për atë Kosovë, e cila është pjesa më e qenësishme, më jetike, e krejt Shqipërisë.

9.ANËTARI I SHTATË, i ngarkuar për punët me shqiptarët në Rep.e Shqipërisë. Selia në Tiranë. Do të mjaftonte që ai të bëhej përçues i një fryme për të luftuar FRONTALISHT e BASHKARISHT një numër të pafund mangësish të kësaj bashkësie shqiptare, e cila sot do të duhej të ishte të paktën në nivelin e bashkësisë së kroatëvet.

Kjo është përbërja e Kryesisë së Përkujdesjes Gjithshqiptare. Hollësitë, që, doemos, janë të shumta, do të mund të parashtrohen në kohën kur t'i hyhet krijimit të këtij INSTITUCIONI.

II.Organi i dytë i Përkujdesjes, siç e thashë, përbëhet prej një numri të pakufishëm organesh vendorë. Me fjalë të tjera, organi i dytë formohet prej një numri të pacaktuar njësish vendore, të përhapura kudo ku ka shqiptarë. Në një të ardhshme, nëse shqiptarët do ta quajnë të nevojshëm një organizim të këtillë, numri i këtyre njësive vendore parashikohet të arrijë në 150 mijë. Kuptohet, kjo do të mund të ndodhë VETËM GRADUALISHT, duke filluar nga NJËSHI. (Dhe, më vonë, duke ingranuar edhe shtetet apo shtetin shqiptar në këtë punë). Këta organe vendorë unë i kam quajtur FJALËMIRA TË GJUHËS SHQIPE.

FJALËMIRA E GJUHËS SHQIPE përfshin nën juridiksionin e vet një numër të kufizuar, pra, një numër të vogël familjesh shqiptare, rreth 100 familje ose më pak, të cilat jetojnë territorialisht afër njëra-tjetrës. Dua të theksoj që në fillim, që ky INSTITUCION i Përkujdesjes Gjithshqiptare as që do të kish kurrafarë kuptimi, pa ekizistencën e FJALËMIRAVET të veta.

Përshkrimin më të hollësishëm të këtij organi lokal të Përkujdesjes, unë e kam bërë në njërin prej shkrimevet të mi, publikuar në portalin "Pashtriku" me titull "Fjalëmira e Gjuhës Shqipe". Këtu po

jap vetëm një paraqitje të përmbledhur, në mënyrë që lexuesi të mos detyrohet për t'u marrë me hollësira.

Secila Fjalëmirë e Gjuhës Shqipe duhet të ketë një LOKAL, një AMBIENT, ku njerëzit të kenë ku të mblidhen. Ky është themeli i funksionimit të një Fjalëmire, madje, ky është edhe themeli i funksionimit të krejt Institucionit tonë të Përkujdesjes. Nuk ke ku e bën përkujdesjen, nëse nuk ke një VEND për t'u mbledhur.

Pas një analize të fundit, konkluzioni im është që, LOKALI (shtëpia, ndërtesa), e cila duhet t'i ngjajë një faltoreje kombëtare, brenda Atdheut, duhet të jetë pronë e përhershme, e përjetshme, e Përkujdesjes. Pra, e blerë ose e dhuruar. Ndërsa jashtë Atdheut (dmth jashtë kufijvet të Shqipërisë Gjeografike, e cila këtu në Ballkan shtrihet në 6 shtete), mund të jetë edhe ambient që përkohësisht të merret me qera. Por, udhëzimi përfundimtar është ky: Ndërtesa ku do të zhvillohen ceremonitë dhe veprimtaritë e tjera të Përkujdesjes, e quajtur prej nesh solemnisht Fjalëmirë e Gjuhës Shqipe, është mirë të jetë gjithkund pronë e përjetshme e Përkujdesjes.

Në krye të çdo Fjalëmire vihet, emërohet, një person i specializuar për këtë punë dhe që paguhet për punën që bën. Si rregull, ai (ose ajo) duhet të jetë i (ose e) diplomuar për gjuhën shqipe, por duhet të ketë edhe cilësi të tjera, si aftësi për të punuar me njerëzit, erudicion të gjithanshëm, në histori, në gjeografi, në drejtësi, në etnokulturë… emërtimi i këtij nëpunësi është: Ligjërues i Fjalëmirës së Gjuhës Shqipe, ndërsa njerëzit që komunikojnë me të, si rregull, e thërrasin profesor (ose profesoreshë).

Punët kryesore të një Ligjëruesi të Fjalëmirës së Gjuhës Shqipe janë këto:

1.Në çdo javë, zakonisht të shtunën mbas dite, organizon dhe drejton ceremoninë javore të Fjalëmirës. Rregullat e kësaj ceremonie të përjavshme janë rigorozisht të përcaktuara.

2.Në njërin prej intermexove, të kësaj ceremonie, realizohet kontributi monetar i pjesëmarrësvet, i domosdoshëm për funksionimin normal të krejt këtij INSTITUCIONI. Edhe rregullat e këtij kontributi janë rigorozisht të përcaktuara, në mënyrë që të shmanget çdo mundësi abuzimi.

3.Po në ditën e shtunë, pasi të ketë përfunduar ceremonia, banorët vendorë, që bëjnë pjesë në juridiksionin organizativ të Fjalëmirës, paraqesin problemet personalë ose gruporë, të cilët kërkojnë një zgjidhje. Numri i problemeve që kanë shqiptarët në kohën tonë është aq i madh, sa vetëm kjo do të duhej të na motivonte mjaftueshëm për ta krijuar këtë organizëm.

4.Gjatë gjithë javës, Ligjëruesi i Fjalëmirës bën përpjekje për t'i zgjidhur ose vënë në rrugën e zgjidhjes problemet që i janë parashtruar. Të shtunën tjetër ai i raporton komunitetit për rezultatet e përpjekjevet të tija. Për të njëjtat gjëra dhe për krejt punën e vet Ligjëruesi i dërgon raport të përjavshëm edhe Kryesisë së Përkujdesjes.

5.Ligjëruesi i Fjalëmirës ka detyrë të përhershme edhe mbledhjen e thesarit kulturor të komunitetit, të cilit ai i shërben. Edhe këtu ka aq shumë punë, sa do të mjaftonte vetëm kjo, si motiv për t'i hyrë kësaj pune me gjithë seriozitetin e duhur. Është fjala edhe për mbledhjen e sistemimin e thesarit kulturor, por edhe për ruajtjen dhe kultivimin e tij.

Me gjithë zemërimin e fuqishëm që mund të kemi, duke parë përditë, ngjarje pas ngjarjesh, indinjuese dhe revoltuese, prapëseprapë, nuk besoj se është nevojshme tani të dalim e të bërtasim: VËLLEZËR SHQIPTARË! Të themi: MBLIDHUNI! Të themi: BESOMËNI MUA! Nuk është, pra, e nevojshme të lëshojmë KUSHTRIMIN e të vëmë kujën. S'është koha për britma e për çirrma patetike, midis tjerash, edhe sepse ato nuk janë tashmë të dobishme. As për tubime dhjetëra e qindramijësh, s'është koha. Është koha kur njerëzit, në këtë rast shqiptarët, duhet të veprojnë MENÇURISHT. Të meditojnë, të kontaktojnë, të ulen e të bisedojnë, pa cmirë, pa xhelozi, pa prapamendime, pa fodullëk, pa mendjemadhësi.

Përkujdesja Gjithshqiptare nuk është thirrje për luftë. As Fjalëmira e Gjuhës Shqipe nuk do të bëhet kurrë vatër e luftënxitjevet dhe e kryengritjevet. Prandaj edhe janë quajtur: PËRKUJDESJE dhe FJALËMIRË.

Krejt problemi është, që kjo nismë TË PROPAGANDOHET. Këtu ka shumë rol MASMEDIA jonë. Të shkojë, mençuria punëmbaruese, mençuria punëkryerëse, te veshi i dëgjuesvet dhe te syri i lexuesvet. Ta marrë përsipër këtë punë sidomos BREZI I RI i shqiptarëvet, ajo pjesë e rinisë sonë, 25-30-vjeçare, që I KA: KTHJELLTËSINË, LARGPAMËSINË DHE VULLNETIN e nevojshëm, për t'i kryer punët ashtu si të jetë më e mira, për Kombin, të cilit i përkasin, por edhe për kohën, në të cilën jetojnë.

Kontaktet: pashtriku-pz@hotmail.de & gj.dabaj@yahoo.com

Nr.Cel: 00355 692567880,

Gjokë Dabaj - Durrës, 12 shkurt 2013.

* * *

INSTITUCIONI I PËRKUJDESJES GJITHSHQIPTARE

(GJOKË DABAJ: "STRATEGJIA E SHQIPTARËVET", Tiranë 2011, f.214-259)

Shqetësimi alarmues

Krejt çka kemi parashtruar deri tani, na çon në disa konkluzione tepër të rëndësishëm. Tepër të rëndësishëm, por edhe tepër shqetësues njëkohësisht.

1. Kombi shqiptar, në të kaluarën, ka qenë disa herë i rrëzikuar për t'u zhdukur. Filluar që nga kohët para se të merrte këtë emër e deri më sot, ky komb, kjo etni, ka ardhur në ngushtim të vazhdueshëm, në një ngushtim vërtet alarmues, shoqëruar jo me muzikë dasmash, por me funerale copërash toke dhe turmash njerëzish. Mbështetur në krejt ato që na kanë ndodhur dhe duke i analizuar shkaqet pse na kanë ndodhur, ne arrijmë në konluzionin se edhe në të ardhshmen, nëse nuk merren **masa shumë serioze**, ne prapë do të shkojmë drejt ngushtimit, drejt pakësimit, drejt asimilimit dhe përfundimisht drejt zhdukjes.

2. Faktorët që na kanë çuar në një të këtillë përfundim alarmues, janë disa:

a. Shtetet dhe kombet fqinjë me ne, janë jomiqësorë dhe jodashamirës ndaj nesh (Shprehje këto shumë të buta, por që ne nuk po duam t'i themi ndryshe)

b. Të gjithë shtetet e mëdhenj, të cilët kanë mundësi të na përkrahin dhe do të duhej të na përkrahnin më fuqishëm, duket se kanë më shumë interesa të lidhen me fqinjët tanë se sa me ne. Ose të paktën ashtu u duket atyre.

c. Vetë ne nuk po tregohemi as të vëmendshëm, as energjikë, as të rregullt dhe as të denjë për të merituar përkrahjen e të tjerëvet. Madje strukturat tona të të gjithë nivelevet, nuk po janë në gjendje të sigurojnë simpati reale as prej popullit të vet.

3. Atdheu i shqiptarëvet vazhdon të jetë i ndarë në 6 shtete dhe asnjëri prej këtyre shteteve nuk është në gjendje, nuk i ka potencialet as politikë, as ekonomikë, as kulturorë e as ushtarakë, për t'u përkujdesur efektivisht për 5 pjesët e tjera. As të 2 së bashku, Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës, nuk i kanë ata kapacitete.

4. Kombi ynë është i ndarë në 3 fe të ndryshme dhe asnjëra prej këtyre feve nuk i ka prerogativat për të marrë përsipër përkujdesjen shpirtërore ndaj krejt Kombit tonë. Bashkësia Islame nuk mund të

përkujdeset për ortodoksët e për katolikët, Kisha Ortodokse Autoqefale Shqiptare nuk mund të përkujdeset për myslimanët e për katolikët, Kisha Katolike Shqiptare gjithashtu nuk i ka ato mundësi. Në këtë mënyrë, roli i fevet në Kombin tonë mbetet vetëm ai i shkuarjes mirë njëra me tjetrën. Por kjo nuk është e mjaftueshme dhe, për më keq, shkuarja mirë midis tyre mund të mos jetë e përjetshme.

5. Kombi Shqiptar, **edhe mbasi të jetë inkuadruar në Bashkimin Evropian**, duke mos qenë i njësuar as shtetërisht as fetarisht (dhe duke manifestuar gjithë këto të meta të të gjithë llojevet), **do të mbetet përsëri i rrëzikuar.**

Si dëshmi për këtë le të marrim vetëm gjendjen e ortodoksëvet shqiptarë dhe të arvanitëvet në shtetin grek. Megjithëse shteti grek ka vite që është anëtar i Bashkimit Evropian, as ortodoksët shqiptarë të atij shteti, çamët etj, as arvanitët, që gjithashtu janë ortodoksë, nuk i kanë as 3 elementët më të domosdoshëm që duhet t'i gëzojë çdo etnitet në një bashkësi demokratike: Regjistrimin si shqiptarë ose si arvanitë, shkollimin në gjuhën amëtare dhe liturgjinë në gjuhën amëtare. Të mos flasim pastaj për parti nacionale, për pëfaqësimin komunitar në parlament, për shtypin në gjuhën amëtare apo për median elektronike në gjuhën amëtare. Ata s'kanë asgjë. U rruat që janë në BE!

6.Rrjedhimisht, **brezi i sotëm i shqiptarëvet është i detyruar të bëjë diçka**. Ai është detyruar të gjejë rrugë shpëtimi e konsolidimi, në mënyrë që në të ardhshmen të mos na ndodhin tragjedira siç na kanë ndodhur në të kaluarën.

I shqetësuar në këtë mënyrë, autori i këtij parashtrimi është i mendimit që ne **duhet sa më parë të krijojmë një INSTITUCION tonin gjithëshqiptar**, i cili të veprojë sipas një **strategjie**, jo më të lidhur me 1 shtet të vetëm, as me 2 shtete, jo më të lidhur me 1 a 2 territore, jo më të lidhur me 1 apo 2 parti dhe jo më të lidhur me njërën prej fevet, por të lidhur me krejt Kombin tonë kudo që ai jeton.

Ky institucion duhet të jetë **institucioni i përkujdesjes së gjithanshme** shpirtërore, edukative, arsimore, ekonomike, juridike, artistike, sportive, të mbrojtjes etj.etj, mbi të gjitha: propagandistike, politike e diplomatike, për secilin shqiptar a grup shqiptarësh, të cilëvet mund t'u paraqitet nevoja për një të tillë përkujdesje dhe për secilën pjesë të vendit të tyre.

Synimet strategjikë

1. **Të përmirësojmë individin shqiptar**. Kombi përbëhet prej individësh. Pa individ të përparuar nuk ka Komb të përparuar. Një Komb i mirë përbëhet prej individësh të mirë.

2.**Të përmirësojmë, zbukurojmë e ruajmë mjedisin ku jetojmë**. Atdheu përbëhet prej pjesësh. Sa më shumë pjesë të tija të jenë të bukura, të jenë ekonomike dhe të këndshme për të jetuar aty, aq më i bukur, ekonomikisht i levërdisshëm dhe i kënshëm për të jetuar aty, është Atdheu.

3. **Të përkujdesemi njëkohësisht, si për pjesët, ashtu edhe për tërësinë tonë**. Kur një pjesë e Kombit dhe e Atdheut nuk është mirë, krejt Kombi e Atdheu nuk janë mirë. Me fjalë tjera, kjo thuhet kështu: Të mbrojmë të drejtat dhe dinjitetin e secilit shqiptar dhe të secilës pjesë të Shqipërisë. Nëse sot guxon dikush të shkelë të drejtat dhe dinjitetin qoftë edhe të një shqiptari të vetëm apo të një pjese të Shqipërisë, e pjesët e tjera nuk ndjehen, nesër vjen radha e individëvet të tjerë dhe e pjesëvet të tjera.

4. **Të shkojmë mirë njëri me tjetrin**. Të punojmë për të zgjidhur me drejtësi çdo mosmarrëveshje para se të ndodhin tragjeditë. Të krijojmë osmozën e mirëkuptimit e të harmonisë gjithshqiptare.

5. **Të shkojmë mirë me kombet që na rrethojnë dhe me të gjithë kombet e tjerë të Botës**. (Natyrisht, nëse edhe ata duan). Të punojmë për të zgjidhur me drejtësi çdo mosmarrëveshje me kombet që na rrethojnë dhe me të gjithë të tjerët.

6. **Të ngrejmë autoritetin dhe dinjitetin e Kombit e të Atdheut tonë** në shkallën më të mundshme të barabartësisë me të tjerët. Nuk

duhet të ketë arsye që të jemi poshtë kombevet të tjerë në asnjë aspekt.

7. Të mos lejojmë që Kombi ynë të zvogëlohet edhe më tej dhe të mos lejojmë që Atdheu ynë të ngushtohet edhe më shumë.

Kjo do të thotë: Jo vetëm **të parandalojmë luftërat**, të cilat në vendin tonë, në të gjitha kohët janë shoqëruar me masakra rrënqethëse, por edhe t'u bëjmë ballë përditshmërisht mijëra veprimevet të përditshëm dhe fjalëvet të pëditshme, që në të katër anët kryhen e thuhen kundër nesh. Kryhen e thuhen, mjerisht, edhe prej vetë nesh.

***

E gjithë kjo punë, që nga pika 1 deri në pikën 7, është aq e vështirë, sa shqiptarëvet të sotëm do t'u duhen e pakta **100 000 heronj** vetëprivues e ndonjëherë edhe vetëmohues, për ta vënë në vijë këtë punë.

Probleme të organizimit

Problemi nr. 1: Si dhe për çdo organizim tjetër, edhe për organizimin e Institucionit të Përkujdesjes Gjithëshqiptare, **duhen para**. (Shkurt do t'i themi ***Përkujdesje***, zyrtarisht ndoshta: ***organizatë*** apo ***shoqatë***) Pa para nuk ka kurrfarë organizimi. S'ka nevojë të zgjatemi në këtë pikë. Do të shohim në kapitujt e mëtutjeshëm sa shumë para do të duhen. E vumë si pikë të parë këtë problemin e madh të paravet, nxitur edhe prej 2 të vërtetavet tona shumë të rënda: 1.Ka shqiptarë që flasin për patriotizëm, por mendjen e kanë te përfitimet që nxjerrin prej "patriotizmit". 2.Ka shqiptarë të tjerë që i japin 5 lekë dhe pastaj mburren sikur i kanë bërë shërbime të jashtzakonshëm Atdheut.

Organizuesit e ***Përkujdesjes***, si dhe të gjithë të tjerët që do t'u shkojnë pas, as kanë ndërmend të pasurohen me këso mënyrash, as kanë ndërmend të mburren se kanë bërë sakrifica të mëdha. Paratë i duhen ***Përkujdesjes*** **vetëm për të bërë punët** dhe për asgjë tjetër. (**Përfitim ekonomik** natyrisht që kërkohet të ketë, por ai do të jetë **i**

tërthortë dhe gjithkombëtar, jo drejtpërdrejtë i një grupi organizuesish: as i krerëvet, as i anëtarëvet.) Për këtë arsye, të gjitha paratë që do të mblidhen, do të dihet kush i ka dhënë, kur i ka dhënë dhe sa ka dhënë. Edhe 100 lekë të vjetër në i pastë dhënë dikush, atij do t'i jepet dokumenti përkatës dhe pastaj, emri i tij bashkë me shumën, do të nxiret në gazetë, përjashtuar rastet kur dhënësi nuk dëshiron të publikohet. E njëjtë do të jetë edhe transparenca e shpenzimevet. Të gjithë shpenzimet duhet domosdoshmërisht të publikohen ose, për raste të veçantë, të arsyetohen me komunikata të brendshme.

I themi këto gjëra, sepse në lëvizjen tonë kombëtare të dekadavet të fundit, janë vënë re shumë raste të pakëndshëm, deri edhe revoltues, kur njerëzit kanë dhënë paratë dhe s'është marrë vesh ku kanë shkuar ato para. Në disa ambiente, midis mërgimtarëvet tanë (sepse brenda Atdheut as që janë organizuar donacione të kësaj natyre), ka shkuar puna deri atje, sa është thënë me zë të lartë: ***Boll, se nuk japim më asnjë cent ! Kushdo që vjen për të na takuar, nuk vjen se na do shumë, por sepse i duhen para.*** Kësaj gjendjeje natyrisht i duhet dhënë fund. ***Përkujdesja Gjithkombëtare***, o duhet të vendosë drejtësi edhe në këtë aspekt, ose ajo as që do të mund të themelohet.

Të gjithë e dimë sa shumë para janë duke shpenzuar në dëm të Kombit tonë dhe në emër të kuazinacionalizmit të tyre, fqinjët tanë, ata që i kanë hartuar prej kohësh strategjitë e tyre. Madje edhe në emër të gjoja përkatësisë së tyre fetare! I ndëshkoftë Zoti, ata që e përdorin fenë për të dëmtuar popujt e tjerë! Ne, ndërkaq, nuk do t'i përdorim paratë tona për të dëmtuar popujt e tjerë. Ne do t'i përdorim ato për të shpëtuar shqiptarët nga zhbërja, nga dekompozimi.

Problemi nr. 2: **Fillimi i punës**. Nuk është lehtë të fillohet puna, megjithatë, gjykuar nga fakti që një shumicë shqiptarësh e kanë kuptuar tashmë që **duhet bërë diçka**, se nuk na mbetet shumë kohë për të pritur, kjo nismë, sidoqoftë, duhet të realizohet.

Opcion: Takohen diku 4-5 miq, atdheekombdashës të sinqertë, e diskutojnë çështjen, caktojnë një kryetar nismëtar, hapin një numër llogarie në një bankë dhe e publikojnë njoftimin apo thirrjen përkatëse. Në njoftim apo thirrje do të thuhej edhe kjo: ***Të gjithë ata shqiptarë që dëshirojnë të bëhen pjesë e Përkujdesjes Gjithshqiptare, të derdhin në numrin e sapohapur të llogarisë kuotën e vet vjetore të anëtarësisë: 2400 lekë të rinj, 24 euro, 24 franga, 24 paund, 24 dollarë, 24 jenë, gjithëmonë përafërsisht sa vlefta reale e 2400 lekëvet të rinj.*** Nëse kjo kuotë konsiderohet e pakët, atëherë grupi nismëtar anoncon një kuotë tjetër.

Sapo të mblidhet një shumë e caktuar dhe sapo të bëhen aq nismëtarë sa duhen për legalizimin e institucionit ("joqeveritar dhe jofitimprurës"), duhet të fillojë puna e legalizimit, në secilin shtet sipas ligjevet të atij shteti. Që këtu fillojnë pengesat.

Fillojnë pengesat, sepse në shtetin grek ne kërkojmë që arvanitët të regjistrohen në dokumentet e identitetit si arvanitë, shqiptarët ortodoksë në Çamëri e gjetkë të regjistrohen si shqiptarë, për të gjithë këta kërkojmë që të ketë shkolla shqipe dhe liturgji në shqip. A do ta lejojnë qeveritë greke një organizatë me një program të këtillë?

Në shtetin turk ne do të kërkojmë që të gjithë shqiptarët e atjeshëm të regjistrohen në dokumentet e vet si shqiptarë e jo si turq. Për të gjithë ata shqiptarë, ne kërkojmë që të hapen shkolla shqipe të të gjithë niveleve. A do ta lejonë qeveritë turke të cilitdo spektër një organizatë me një program të këtillë?

Në shtetin sërb ne do të kërkojmë që, bazuar në numrin e zgjedhësvet, sa deputetë sërbë të ketë në parlamentin e Prishtinës, aq deputetë shqiptarë të ketë në parlamentin e Beogradit. Ne do të kërkojmë që, në Sërbi, të gjithë monumentet e kohës ilire, që nga varrezat tumulare deri te kështjellat apo bazilikat paleokristiane, të shpallen monumente të kulturës iliro-shqiptare dhe të vihen nën mbrojtjen e shtetit sit ë tillë. Nëse sërbët kërkojnë universitet sërb në Prishtinë dhe në Mitrovicë, ne do të kërkopjmë universitet

shqiptar në Preshevë dhe në Beograd. A do ta lejojnë qeveritë sërbe një organizatë me një program të këtillë?

Në shtetin e Maqedonisë, nëse sllavomaqedonët kërkojnë që fëmijët e atjeshëm shqiptarë të fillojnë për ta mësuar gjuhën sllavomaqedone qysh në klasë të parë, ne do të kërkojmë që edhe fëmijët sllavomaqedonë të fillojnë për ta mësuar shqipen që në klasë të parë. Nëse ata kërkojnë që fëmijët tanë atje të fillojnë për ta mësuar sllavomaqedonishten që në klasë të katërt, ne do të kërkojmë që edhe fëmijët e tyre të fillojnë për ta mësuar shqipen që në klasë të katërt. Vëç kësaj, ne do të kërkojmë që në sheshin kryesor të Shkupit të ngrihet monumenti i Justinianit të Madh, monumenti i Belizarit, monumenti i Nënë Terezës, monumenti i 20 000 shqiptarëve që e çliruan Shkupin prej osmanëvet më 18 gusht 1912, në Manastir do të kërkojmë të ngrihet monumenti i Qiriazëvet dhe i Bajo Topullit. Në Ohër na duhet një përmendore e madhe e Gropajvet. A do ta pranojnë sllavomaqedonët një organizatë të këtillë, e cila realisht nuk do të ketë asgjë kundër tyre?

Në Mal të Zi ne do të kërkojmë shkolla shqipe për të gjithë shqiptarët që jetojnë në Tivar e në Podgoricë dhe do të këkojmë që rrënojat e Dioklesë e të Meteonit, mozaikët e Rizonit etj. të shpallen trashëgimi kulturore e shqiptarëvet. A do ta lejojnë qeveritë malaziase një organizatë me një program të këtillë?

Por, nëse nuk duam që sllavët jodemokratë të vazhdojnë ta quajnë Kalanë e Rozafës kështjellë sërbe, nëse nuk duam që grekët jodemokratë të vazhdojnë ta quajnë Shqipërinë Jugore (Vorio Epirin) tokë greke, dhe në fund, edhe njërët edhe tjetrët t'i bëjnë realisht të tyret këta vende, ne jemi të detyruar të kërkojmë legalizimin e organizatës sonë ***Përkujdesja Gjithshqiptare***, si i vetmi opcion i mundshëm për t'u pranuar prej të gjitha forcave demokratike të mirëfillta.

Problemi nr.3: Anëtarësia, armatë gjithndryshuese apo psherëtimë dhe rënkim i një pakice shqiptarësh frymëfikur?! Doemos, armatë gjithndryshuese! Opcioni ynë është opcioni më

optimal i mundshëm, për ta vënë Kombin tonë në rrugën më të garantuar të prosperitetit. Ky opcion nuk mund të ketë qortime përsa i përket bazës themelore dhe parimevet kryesorë. Mund të ketë vetëm përmirësime në elementë të veçantë.

Nisur nga kjo domosdoshmëri jetike, ne kërkojmë që **asnjë shqiptar të mos mbetet pa u bërë anëtar i Përkujdesjes Gjithshqiptare**. Të parët në kohë do të jenë, sigurisht, ata shqiptarë që prej kohësh digjen për të pasur një formë organizimi sa më efikase. Këta janë nismëtarët dhe themelvënësit.

Shikuar në aspektin e rëndësisë, anëtarët që këtij organizimi të madh do t'i jepnin pamjen e seriozitetit e të përkushtimit, të qëndrueshmërisë dhe të forcës, do t'ishin: Presidentët dhe ish-presidentët e Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës, kryeministrat, ministrant, kryeparlamentarët dhe parlamentarët, kryeushtarakët, diplomatët, kryepartiakët, kryeklerikët, akademikët, profesorët që mbajnë tituj të lartë shkencorë, shkrimtarët e spikatur, kryegjyqtarët, avokatët, prokurorët, kryegazetarët, kryeaktorët, kryekëngëtarët, kryemuzikantët, kryesportistët, artistë të merituar, personalitete që mbajnë titullin "***Nderi i Kombit***", presidentët e kompanivet tona të ndërtimit, të industrisë, të tregtisë, kryepronarët që tashmë nuk i mungojnë Kombit tonë, producentë të ndryshëm, kryebankierë. Të gjithë këta do të ishin **ANËTARË NDERI** të **Përkujdesjes** sonë **Gjithshqiptare**. Ashtu siç është një president i Greqisë edhe besimtar i Kishës Ortodokse Greke, ashtu siç është një president i Sërbisë edhe besimtar i Kishës Pravosllave Sërbe, ashtu një president i yni, një kryeministër, një kryetar partie, pa u penguar që të jetë besimtar i njërës prej fevet tona, do ta ketë për **detyrë patriotike** të jetë edhe anëtar i **Institucionit të Përkujdesjes Gjithshqiptare**. Do ta ketë për **nder** e, njëkohësisht, edhe Përkujdesja Gjithshqiptare do të jetë e nderuar prej tij.

Nëse këta personalitete nuk do të bëhen pjesë e këtij organizimi, kjo do të jetë shenja më bindëse që Kombit tonë i mungon tragjikisht

elita kombeatdhedashëse. Kjo do të jetë njëkohësisht një shenjë e dhimbshme që Kombi ynë nuk ka për t'u rimëkëmbur, sado që fitues të ndryshëm të zgjedhjevet mund ta reklamojnë veten si promotorë të suksesevet tanë, të paparë ndonjëherë.

Në anë tjetër, nëse **Përkujdesja** jonë **Gjithshqiptare** do të mbushet me **anëtarë nderi** të këtij niveli, kjo do të jetë shenja më shpresëdhënëse që shqiptarëvet po u çelet një rrugë e ndritur drejt së ardhshmes. Le të shpresojmë që do të jetë kështu!

Anëtarë të tjerë të *Përkujdesjes Gjithshqiptare* duhet të bëhen të gjithë ata shqiptarë që i kanë mundësitë për t'ia dhënë kësaj *Përkujdesjeje* 24 euro në vit, qoftë edhe me shtërngime në shpenzimet e tjerë. Le t'i lënë disa kafe a disa birra pa i pirë, le t'i zvogëlojnë sadopak qokat e dhuratat dhe le t'ia paguajnë *Përkujdesjes* anëtarësinë e vet, sepse është pikërisht kjo *Përkujdesje*, e cila do t'u sjellë shqiptarëvet ditë më të mira e më të sigurta në të ardhshmen.

Në rrethanat në të cilat jetojmë ne, është e pritshme që të ketë edhe të atillë shqiptarë që do të duan të bëhen anëtarë të këtij Institucioni, por që nuk do të dëshirojnë apo nuk do të mundin ta shpallin botërisht anëtarësimin e vet. Këta do të jenë **anëtarët ilegalë**, pranimin e të cilëvet do të mund ta kryejë vetëm **Kryesia e Përkujdesjes**.

Po kjo **Kryesi** do të mund të pranojë, me një procedurë fare të thjeshtë, edhe të atillë anëtarë, të cilët të kaluarën e vet nuk e kanë pasur të mirë. Dera e kontributit në dobi të Kombit nuk mund dhe nuk duhet t'i mbyllet askujt. Të punosh për Kombin e për Atdheun, nuk është asnjëherë vonë. Shërbimi ndaj Atdheut dhe Kombit është mënyra më e mirë për të shlyer çdo njollë që dikush mund t'i ketë vënë vetes.

Kryesia e Përkujdesjes Gjithshqiptare do ta quajë të suksesshëm misionin e vet, vetëm atëherë kur anëtarësia e këtij organizimi madhor gjithshqiptar do të ketë arritur numrin 5 000 000 (pesë

milionë), shifër kjo e përafërt me 30% të krejt numrit të shqiptarëvet që sot jetojnë në Atdheun e vet dhe nëpër Botë.

Problemi nr.4: **Puna në terren** duhet të bëhet me **grupe qindësh,** mbledhur rreth një qendre që unë e kam quajtur ***FJALËMIRA E GJUHËS SHQIPE***. Sigurisht, jo strikt, por, me më pak, efekti do t'ishte mjaft i mangët, kurse, me më shumë, prapë efekti vjen duke rënë. Megjithkëtë, atje ku s'janë mundësitë, grupet mund të pranohen edhe më të vegjël, kurse atje ku terreni e kërkon një gjë të tillë, grupet mund të jenë edhe më të mëdhenj.

Në krye të çdo ***FJALËMIRE***, organizuar sigurisht mbi bazën e VENDBANIMIT, qëndron zakonisht **një njeri i ditur**. Mund të jetë me shkollë të lartë, porn ë raste të veçantë, mund edhe të mos jetë me shkollë të lartë. Me ithtarët e vet ai ka për detyrë të organizojë e pakta 60 veprimtari në vit: 1 në çdo javë dhe disa të tjera në ditë të shënuara: **Dita e Flamurit**, absolutisht e domosdoshme dhe sa më madhështore; **Dita e Kosovës**, me të njëjtat përmasa; **Dita e Shkollës Shqipe**; **Dita e Themelimit të Përkujdesjes**; **Dita e të Rënëvet dhe e të Masakruarvet.**

Në të gjitha kryejavët dhe në të gjitha këto ditë, kryesuesi i ***FJALËMIRËS***, fillimisht duhet të bëjë takim me grupin e vet këshillues. *Kemi këto gjëra që na kanë ndodhur në vendbanimin tonë: Këta e këta, nga banorët tanë,(ose bashkëkombës tanë) janë pa punë, kemi këta fëmijë që nuk shkojnë në shkollë, kemi këta raste që drogohen, filani ka një problem në familje, midis 2 familjeve filan e filan ka filluar sherri. Ç'të bëjmë, që të mos shkojë puna deri te vrasjet?!* Një varg tjetër problemesh: ***Papastërtia në vendbanim, ujësjellësi, taksat, fusha e sportit, reklamat në gjuhë të huaja***. *Nga Kryesia e Përkujdesjes kemi marrë këta udhëzime apo qortime. Cilët nga këta shqetësime do t'i publikojmë sot dhe me cilët do të meremi veç e veç pa i publikuar? Cilin nga anëtarët tanë do të porositim për të folur me filanin që rri gjithë kohën i dehur?* Bëhen edhe letra apo kërkesa zyrtare dhe me kaq mbaron takimi me grupin këshillues.

Pjesë tjetër e veprimtarisë është ceremoniali 1 herë në javë. Në fillim, ***FJALËMIRI***, njeriu që shërben në një ***FJALËMIRË***, mban një bisedë në lidhje me Kombin e me Atdheun tonë. Ai duhet të ketë informacion të bollshëm nga historia e iliro-arbro-shqiptarëvet, duhet të njohë gjeografinë e Shqipërisë, të ketë dijeni mbi ngjarjet aktuale që lidhen me Kombin tonë. Për këtë arsye kreun e grupit zakonisht e thërrasin: ***Profesor***.

Mbas fjalës së **Profesorit**, duhet të ketë një koncert ose spektakël tjetër me përmbajtje patriotike. Vendimet e përbashkët, në rastet kur janë për t'u publikuar, i përcillen medias elektronike dhe asaj të shkruar.

Titullari i secilës *FJALËMIRË*, vetëkuptohet, merrë një pagë të caktuar mujore. Por secila *FJALËMIRË*, sipas mundësivet e rrethanavet, duhet të sigurojë edhe donacione prej atyre anëtarëve apo simpatizuesve, të cilët janë në gjendje ta ndihmojnë *PËRKUJDESJEN* tonë. Gjysmën e donacionevet çdo *FJALËMIRË* është e detyruar t'i arkëtojë në llogari të Qendrës. Në krye të çdo viti, i cili llogaritet nga muaji i themelimit, bëhen votimet për titullarin e *FJALËMIRËS*, votime të cilët doemos duhet të jenë **të fshehtë**, dhe ku duhet të marrë pjesë 1 (vetëm 1) i deleguar i Kryesisë.

Në secilin prej 6 shtetevet ku banojnë shqiptarët, kuptohet, ka probleme specifikë nga më të ndryshmit. Të gjitha FJALËMIRAT E GJUHËS SHQIPE veprojnë sipas situatavet ku ata jetojnë dhe sipas problemevet që u dalin.

Veç festavet që i përmendëm, në shtete të ndryshëm mund të ketë edhe festa të tjera. Psh në Turqi, **Dita e Shqiptarëvet të Turqisë**. Në Greqi, **Dita e Arvanitëvet**, **Dita e Çamërisë së Vëllazëruar**, në Itali, **Dita e Arbëreshëvet të Italisë,** në Kroaci**, Dita e Arbëneshëvet të Zarës,** në Ukrainë**, Dita e Shqiptarëvet të Ukrainës,** në Rumani**, Dita e Shqiptarëvet të Rumanisë,** në Bullgari**, Dita e Shqiptarëvet të Bullgarisë**. Në të gjithë mërgatën, po edhe në Atdhe, mund të përkujtohet edhe **Dita e Mërgimtarëvet Shqiptarë**.

Të gjithë grupet e ***PËRKUJDESJES GJITHSHQIPTARE*** mund dhe duhet të organizojnë **protesta të koordinuara** për ngjarje apo probleme shumë të rëndësishëm të Kombit tonë. Por këto bëhen me orientim nga Kryesia, e cila doemos duhet ta ketë selinë në Prizren, në vendin ku është sendërtuar i pari autoritet i yni madhor gjithkombëtar.

Problemi nr.5: **Autoriteti** Qendror i Përkujdesjes Gjithshqiptare (i cili, siç e pamë, mund të quhet edhe **Kryesi Gjithshqiptare** ose **Kryesi Kombëtare Shqiptare**), nuk ka nevojë të ketë më shumë se 9 vetë: 1 kryetar, 1 zëvendëskryetar dhe 7 anëtarë.

Organi më i lartë ndërkongresor i **Institucionit ose i Autoritetit të Përkujdesjes Gjithshqiptare** është **Këshilli i Përgjithshëm i Përkujdesjes Gjithshqiptare**. Anëtarë të Këshillit të Përgjithshëm të Përkujdesjes Gjithshqiptare janë të gjithë **lektorët** (për të cilët do të flitet pak më poshtë) dhe të gjithë **titullarët e** *FJALËMIRAVET*. Anëtarë nderi janë, gjithkështu, të gjithë **personalitetet** e atashuar (për të cilët gjithashtu do të flasim pak më poshtë). Këshilli i Përgjithshëm bën **kongresin** e vet 1 herë në 5 vjet ose, në raste të ngutshëm, edhe më shpesh.

Pranë **Autoritetit Qendror**, dmth, pranë **Kryesisë**, duhet të veprojë një administratë sa më e kompletuar, ndryshe strategjia e Përkujdesjes Gjithshqiptare nuk mund të zbatohet me efikasitetin e duhur. Aty janë: Sektori i **informacionit**, (Në sektorin e informacionit veprimtari më vete përbën të informuarit mbi çdo gjë që thuhet e shkruhet rrotull nesh e që lidhet me ne. Psh si janë hartuar tekstet shkollorë të historisë dhe gjeografisë në Sërbi, në Greqi, në Bullgari, në Turqi? Si janë hartuar Historitë e atyre vendeve, enciklopeditë etj dhe i gjithë ky informacion, natyrisht, do të jepet i përkthyer dhe, kur duhet, edhe i botuar në gjuhën tonë), sektori i **statistikavet** (Përkujdesja duhet të dijë në çdo kohë sa shqiptarë ka, ku i ka, si i ka, dhe jo vetëm kaq), sektori i **financës**, sektori i **propagandës** dhe i organizimit të ceremonivet dhe manifestimevet, sektori i **avokatisë kombëtare** (mbrojtja juridike,

si e personavet të veçantë, ashtu edhe e çështjevet me karakter të përgjithshëm kombëtar) etj.etj.

Në sektorin e propagandës, krahas gazetarëvet, grupevet artistikë (këngëtarë, muzikantë, valltarë, sportistë, grupe tifozësh etj etj), pjesë kryesore do të jetë sidomos grupi i madh i **lektorëvet**. Ata **do të jenë dijetarë, njohës të themeltë të Kombit tonë, të cilët do të lëvizin prej grupit në grup për të ligjëruar mbi problemet që lidhen me Kombin tonë dhe mbi mënyrat se si mund të zgjidhen ata probleme**. Nuk është e thënë që një lektor i Përkujdesjes Gjithshqiptare të jetë ekskluzivisht i atij profesioni. Ai mund të jetë njëkohësisht edhe gazetar, këngëtar, jurist, tregtar, sportist, oficer, aktor, ekonomist, mësues, mjek, inxhinier, shofer, murator, kamerier, infermier, aviator, shitës. Mjafton që atij t'i rrahë zemra fort për Kombin dhe Vendin e vet dhe të ketë **njohuri të themelta**, si të fushës së vet, ashtu edhe përgjithësisht mbi Kombin Shqiptar e mbi Shqipërinë. Si ndihmë për t'i plotësuar në vazhdimësi njohuritë e veta, për të paguar udhëtimet dhe për ligjëratat që mban, secili propagandues i këtillë i **kualifikuar** duhet të paguhet, siç ndodh me të gjithë veprimtarët e tjerë. Lektorët e Përkujdesjes Gjithshqiptare, si edhe ata që tashmë i kemi emërtuar ***Fjalëmirë të Përkujdesjes***, do të thirren ***Profesorë***. Këta, në një farë mënyre, do të jenë të ngjashëm me klerikët. Pra, do të jenë **predikues**, veçse, në vend që t'u flasin besimtarëvet të vet për fenë, do t'u flasin atyre për Kombin tonë. Pa një të këtillë **sistem edukimi permanent** ne, as nuk mund të dalim nga prapambetja, as nuk mund t'u dalim përpara rrëziqevet.

Lektorët dhe **fjalëmirët** janë **misionarë të një shqiptarizmi bashkëkohor**. Pa **misionarë** të fesë (prift, hoxhë, sheh, rabin, pastor) nuk ka fe. Në kushtet e globalizmit kontemporan, **pa misionarë të kombit, nuk ka komb**. Njerëzimi ka nevojë për kombe. Kombi Shqiptar ka nevojë më shumë se shumë kombe të tjerë për të pasur **misionarët** e vet.

Pranë Autoritetit qendror të Përkujdesjes Gjithshqiptare do të funksionojë efektivisht edhe një **sektor i konkluzionevet dhe i orientimevet shkencorë mbi gjendjen dhe perspektivat e Kombit e të Atdheut**. Ky do të jetë një **sektor i atashuar** nëpërmjet lidhjevet të cilat sot nuk është vështirë të realizohen: Lidhje me gjuhëtarë, historianë, ekonomistë, inxhinierë, arkitektë, skulptorë, arkeologë, juristë, politologë, parlamentarë me kombësi shqiptare, funksionarë shtetesh me kombësi shqiptare, kryepasanikë të Kombit, kryepartiakë të partivet shqiptare etj.etj. Do të jetë, pra ky një kontigjent i madh i përbërë prej kryeudhëheqësvet dhe kryedrejtuesvet të Kombit Shqiptar, me të cilin Kryesia do të koordinojë punët më të domosdoshme. Autoriteti Qendror i Përkujdesjes, **Kryesia**, nëpërmjet letërkëmbimit me këta njerëz, nëpërmjet lidhjevet të vazhdueshme me anë të internetit, me fakse etj, do të marrë mendime prej tyre, do të japë mendimet e vet dhe, ç'është edhe thelbi i kësaj pune, do të mundohet ta harmonizojë krejt veprimtarinë e **kokavet të Kombit** në të njëjtën hulli të interesavet tanë të përbashkët. Për të zgjidhur problemet që dalin (e që nuk janë të pakët), Autoriteti Qendror i Përkujdesjes Gjithshqiptare do të bëhet, në këtë kuadër, nismëtar takimesh dypalësh apo disapalësh, me qëllim zgjidhjen sa më optimale të konfliktevet. Prej të gjithë kësaj pune, do të nxiren prapë e prapë konkluzionet e nevojshëm shkencorë orientues dhe do t'i jepen Kombit me anë të mjetevet që ai i ka në dispozicion.

Problemi nr.6: Forma pune

(Parimi kryesor: Ne nuk do të përdorim kurrfarë dhune, as kurrfarë presioni, as makinacione. Ne thjeshtë do t'i propagandojmë idetë tona kombëtare dhe do të demonstrojmë në mënyrë shumë serioze në mbrojtje të idevet tona dhe të interesavet të Kombit tonë. Punën më të madhe e kemi me vetëveten. Prej fqinjëvet s'kërkojmë tjetër, veçse fqinjësi normale, krejt të barabartë.)

Sqarim hyrës: Pjesa më e arrirë e Kombit tonë të ndihmojë që të përmirësohet edhe pjesa më pak e arrirë. Pjesa më e vetëdijshme të

përpiqet për të vetëdijësuar pjesën që nuk është sa duhet e vetëdijshme. Pjesët më pak të rrëzikuara të shqiptarëvet t'u vijnë në ndihmë atyre bashkëkombësvet të cilëvet u kanoset ndonjë rrëzik. Të ruhet Kombi shqiptar, si tërësi, nga çfarëdolloj të keqeje që i vjen, qoftë nga vetëvetja, qoftë nga të tjerët. Të punojmë me përkushtim që të jemi një Komb i pajisur me moralin më pozitiv njerëzor. Të punojmë që krenaria jonë kombëtare të arrijë në lartësinë e duhur, pa kaluar kurrë në ksenofobi dhe pa përçmuar kurrë kombet e tjerë. Të përpiqemi që në Kombin tonë të ketë sa më pak njerëz të varfër e sa më shumë familje të mesme e të pasura, mundësisht të mos ketë varfëri ekstreme, por të jenë të gjithë ekonomikisht të siguruar. Të mos pushojmë së përpjekuri që shqiptarët të marrin sa më shumë dituri, sidomos dituri kombëtare, të përvetësojnë sa më shumë profesione, të kemi sa më shumë dijetarë e specialistë të të gjitha fushavet, sportistë e artistë, që ia lartësojnë Kombit emrin dhe famën. Të jemi një Komb i bukur dhe i pastër në të gjitha pikëpamjet. T'i heqim papastërtitë e të gjithë llojevet.

Siç e vumë në dukje edhe pak parë, ne mbrojmë pikëpamjen që, kur një komb bën një **strategji**, ai punën më të madhe duhet ta ketë me vetëveten, pra me pjesëtarët e kombit të vet. Ndaj kombevet të tjerë ne kemi vetëm qëllime të mirë dhe natyrisht kërkesa që të mos na dëmtojnë. Parimi ynë është: Ashtu si duhet të shkojë mirë njeriu me njeriun, ashtu si duhet të shkojë mirë familja me familjen, ashtu duhet të shkojë mirë edhe kombi me kombin. Parim tjetër i yni është: Brezat pasardhës nuk janë fajtorë për çfarëdo veprimi të brezavet paraardhës, qoftë edhe kriminal. Por ata bëhen fajtorë, madje rreptësisht të qortueshëm, nëse nuk i dënojnë veprimet negativë të paraardhësvet të vet.

a. Duhet bërë pa ndërprerë **PUNË INDIVIDUALE**, filluar prej atyre shqiptarëve që nuk dinë shqip dhe që nuk janë të regjistruar si shqiptarë, deri te ata që njihen si shqiptarë, por që bëjnë gabime, faje apo krime, dhe me këtë mënyrë krijojnë për shqiptarët opinion të keq.

Ne nuk duam t'u marrim kombevet të tjerë njerëzit e tyre, por ata njerëz që kombet e tjerë na i kanë marrë, ne dëshirojmë që t'i rikthejmë. Arsyetimi është ky: **Duke ndërruar kombësinë, njeriu i ul vlerat e veta**. Çdo ndërrim kombësie bëhet: a) për interesa egoistë, b)për servilizëm, c)nga frika, ç)për konformizëm, d)për shkak të dhunës. Asnjë prej këtyre motiveve apo shkaqeve nuk ka të bëjë me cilësi pozitive të moralit njerëzor. Si rrjedhojë, as kombi ku ka aderuar një i tillë banor i konvertuar, nuk ka kurrfarë përfitimi. Pëkundrazi, e mbush popullin e vet me banorë të pavlerë. Ndërkaq, rikthimi në identitet është shprehje e virtytit më të lartë njerëzor. Po marrim si shembuj vetëm 2 emra: Xhozef Dioguardin dhe Xhim Belushin. Fundja, kjo është shprehja e modernitetit në kohën tonë: Ruaji vlerat e kombit tend, ndero vlerat e kombevet të tjerë.

Në anë tjetër, shqiptarët që bëjnë gabime, faje apo krime, përsëri i bëjnë dëm shumë të madh Kombit të vet, u bëjnë dëm kombevet të huaj, dhe më së shumti i bëjnë dëm vetëvetes. Me këtë kategori njerëzish Përkujdesja Gjithshqiptare duhet të punojë në mënyrë të pandërprerë. Kjo formë pune **INDIVIDUALE** me njerëzit që bëjnë gabime, faje apo krime, duhet të jetë aq e dendur dhe e përditshme, sa duhet të krijohet përshtypja sikur Institucioni i Përkujdesjes Gjithshqiptare është krijuar enkas për këtë punë.

Nuk mund t'i japësh urdhër tjetrit: Bëhu i virtytshëm! Bëhu i moralshëm! Bëhu i mirë! Aq më pak një pjese jo të vogël të Kombit. Por opinioni duhet krijuar dhe puna mbushamendëse nuk duhet ndërprerë asnjëherë.

Kategoritë e veprimevet negativë në mjedisin tonë, ashtu si edhe në kombet e tjerë, janë dhimbshëm të shumtë. Ne po numërojmë këtu vetëm disa prej atyre vetive që shqiptari duhet t'i luftojë te vetëvetja: Të mos jetë intrigant, të mos jetë gënjeshtar, të mos jetë i pasinqertë, të mos jetë mashtrues, të mos jetë tinzar, të mos jetë i pabesë, të mos jetë i korruptueshëm, të mos jetë korruptues, të mos jetë falsifikues, të mos vjedhë, të mos grabisë, të mos vrasë (përveç rastevet të jetëmbrojtjes dhe atyre gjithnjerëzisht të pranuar), të

mos jetë servil, të mos prostituojë, të mos jetë homoseksual, të mos merret me tregti johumane (organesh, foshnjash, femrash, sakatësh), të mos vetëdrogohet, të mos u ofrojë drogë të tjerëvet (me asnjë lloj forme), të mos e ndotë mjedisin ku jeton (që nga bishti i cigares e shishja plastike deri te llojet e shumtë të industrivet ndotëse), të mos alkolizohet, të mos duhanëzohet, të mos e praktikojë poligaminë, të mos keqtrajtojë burrin, të mos keqtrajtojë gruan, të mos keqtrajtojë prindët, të mos keqtrajtojë fëmijët e vet, të mos jetë dembel. O Zot! A do të mund t'i pastrojë krejt këto papastërti ***PËRKUJDESJA*** jonë?!

Te puna **INDIVIDUALE** hyjnë edhe kontaktet me personalitete të ndryshëm shqiptarë, për të cilët dikush thotë apo faktet dëshmojnë se po veprojnë në dëm të shqiptarëvet, qoftë të një komuniteti më të ngushtë, qoftë në shkallë Kombi. Kjo do të jetë puna më e vështirë e dinjitarëvet të Përkujdesjes Gjithshqiptare. Do të jetë punë e vështirë sepse askush nuk dëshiron ta dëmtojë personalisht, qoftë edhe një personalitet të vetëm, por njëkohësisht askush nuk duhet dhe nuk mund të pajtohet, kur një punë e iks personaliteti dëmton komunitetin apo Kombin. Pikërisht për këto arsye, dinjitarët *PËRKUJDESËS* do t'u afrohen me shumë takt këtyre njerëzve, do të bisedojnë shumë miqësisht me ta dhe, vetëm pasi të jenë ezauruar të gjitha përpjekjet vetjake (**INDIVIDUALE**), do të pëdorin edhe publikimin, demonstrimin dhe, më në fund, autoritetin e vet tek votuesit, nëse do të jetë e mundur.

Nëse arrijmë ta pastrojmë kësisoj vetëveten, të jemi të bindur që s'do të ketë shqiptar që të lakmojë për t'u tjetërsuar dhe s'do të ketë ish-shqiptar që të mos dëshirojë për t'u rikthyer në Kombin e vet.

Punë **INDIVIDUALE** duhet të bëhet psh, me kryetarë të njësivet vendore në shtet ku janë privuar ose mohuar të drejtat e shqiptarëvet, për të cilët dihet se janë shqiptarë por nuk deklarohen as nuk punojnë si të tillë, me parlamentarë të kësaj kategorie, me personalitete të shkencës. Të tillë ka shumë sidomos në shtetin turk e në shtetin grek: Kryetarë të bashkivet në Çamëri e midis

arvanitëvet, në Janinë, në Konicë, në Izmir, në Stamboll, në Ankara e deri në Samsung. Atyre, përkujdesësit tanë duhet t'u afrohen me dashamirësi, nëpërmjet njohjevet personale, dhe t'ua kujtojnë që janë shqiptarë e t'u kërkojnë për të punuar në të mirë të shqiptarëvet.

E njëjta gjë duhet të bëhet me një numër shumë të madh të individëvet nëpër diasporë, të cilët nuk regjistrohen si shqiptarë, mbajnë emra e pranemra të huaj, nuk flasin shqip në familje dhe nuk i çojnë fëmijët në shkollë shqipe. Anëtarët e Përkujdesjes Gjithshqiptare do të kenë njëqind vjet punë me të këtillë individë dhe të njëjtën punë do t'ua lënë trashëgimi edhe pasardhësvet.

Punë **INDIVIDUALE** duhet të jenë në shumë raste edhe kontaktet me personalitete joshqiptarë, për t'i angazhuar edhe ata në të mirë të Kombit tonë. Kontakte madje jo vetëm me ata që potencialisht janë të prirur për të na ndihmuar, por edhe me vetë dëmtuesit tanë. Nuk ka pse të mos kontaktohet personalisht apo të mos i shkruhen letra sqaruese një personi, i cili shkruan apo vepron në dëm të Kombit tonë.

b. **PUNË ME GRUPE**. Kjo është forma vazhduese e punës me persona të veçantë. Ashtu siç i ka krijuar ritet e vet një fe, ashtu duhet të synojë të krijojë ritet e vet edhe një institucion kombëtar i shekujvet XXI e më tej. Sidomos atëherë kur një komb nuk ka një fe të përbashkët.

Atje ku kombet konsiderojnë se kanë të gjithë pjesëtarët e tyre të njëjtën fe, si grekët, sërbët apo turqit, ritet fetarë janë njëkohësisht edhe rite të përbashkimit të tyre kombëtar. Por në kohët tona, kjo formë unifikimi të kombevet është mjaft konservatore dhe përmban në vetëvete mjaft rrëziqe, si për vetë kombet që e praktikojnë, ashtu edhe për etnitë e tjera, të cilat, ose kanë po atë fe ose janë të një feje tjetër, por jetojnë në të njëjtët shtete. Shembuj të përbinshëm të shkombëtarizimit nën tingujt e nën hijen e kambanarevet të Kishës Pravosllave Sërbe, janë arumunët e sërbizuar në shtetin e Sërbisë, shembuj të përbindshëm të asgjësimit fizik nga ana e sërbëvet janë myslimanët e Bosnjës, që i përkasin të njëjtit etnitet sllav, shembuj të tillë të përbindshëm ka, në anë tjetër, psh, historia e 2 shekujvet

të fundit e shtetit grek, pikërisht sepse kombi grek e la veten të udhëhiqej prej idevet konservatore të Patriarkanës.

Sërbia psh, në intervalin prokomunist, e la veten të udhëhiqej nga Akademia Sërbe e Shkencavet dhe Artevet. Por u udhëhoq ashtu si nuk duhej dhe në simbiozë me predikimet disashekullorë pravosllavë, në dëm të kombevet që e rrethojnë.

Ne nuk do të ndjekim ata shembuj. Ne do të jemi **faktor bashkëkohor i harmonisë ndërfetare** brenda Kombit tonë dhe, në të njëjtën kohë, faktor miqësie me kombet e tjerë. Por ritet do t'i krijojmë e praktikojmë, sepse e dimë që **asnjë institucion që ka për qëllim përbashkimin rreth të njëjtit ideal të një shumice njerëzish, nuk mund ta ketë jetën të gjatë, nëse nuk mbështetet në RITE**. Pikërisht këtij synimi do t'i shërbejnë tubimet kryejavorë, rigorozisht kryejavorë, në FJALËMIRAT e Përkujdesjes Gjithshqiptare, predikimet që do të bëhen në ata tubime, koncertet këngëtaromuzikorë, ndeshjet sportive, garat atletike dhe teatrot apo ndonjë cirk i herëpas'hershëm. Shekulli XXI duhet të jetë shekulli i turnevet të qindra grupeve të vegjël nga një shtet në tjetrin, nga një qytet në tjetrin, nga një sallë në tjetrën. Teatër, cirk, këngë, sport, recitime, atletikë, biseda, promovime, ekspozia pikturash…

Punë me **GRUPE** do të konsiderohen edhe thirrjet apo kërkesat thellësisht dashamirëse që do t'u drejtohen grupevet të ndryshëm të Kombit Shqiptar. Psh shqiptarëvet të Tivarit, për t'i rikthyer pranemrat dhe emrat në formën e tyre të natyrshme, për të hapur shkolla shqipe për fëmijët e vet, për t'i gdhendur epitafet e varrevet në gjuhën e vet etj. Thirrje të ngjashme do t'u drejtohen shqiptarëvet të Kosturit, Konicës, Janinës etj, shqiptarëvet ortodoksë të Çamërisë, shqiptarëvet të Rekës në shtetin e Maqedonisë. Paralel me këta do të punohet me grupe shqiptarësh, jashtë Atdheut tonë, psh në Turqi, në Kroaci, në Itali, në SHBA. Dhjetëra shoqatat ekzistuese, pa e dëmtuar destinacionin e vet, do të inkorporohen brenda Përkujdesjes.

Formë më vete e punës me **GRUPE**, më mirë të themi: me kategori, mund të quhet edhe ajo me profesione apo me kuaziprofesione.

Këtu, sigurisht, më shumë me propaganda frontale. Psh mund të punohet me mjekët e me farmacistët (individualisht dhe frontalisht), me juristët, me stafe të veçantë të njërës apo tjetrës ministri, bashki, komunë, ose psh me ata subjekte që paguhen për pastërtinë e vendit e nuk pastrojnë as lagjen ku jetojnë fëmijët e tyre. Më në fund, me prostitutat dhe me tutorët e prostitutavet, me falsifikuesit e dokumentevet, me kultivuesit e drogavet, me falsifikuesit në prodhimin e ushqimevet, me spekullantë të ndryshëm, me tatimorët, të cilët, në vend që të mbledhin taksa prej tregtarëvet, i rrjepin tregtarët dhe trashen për vete, me policët që, në vend të ruajnë rendin, ruajnë e mbrojnë shkelësit e rendit, prej të cilëvet xhvatin para me tufa. Për të gjithë këta duhet të ketë **individualisht** 2 alternativa: O të vazhdojnë të jenë objekt i pakënaqësisë sonë, o të heqin dorë prej "***profesionevet***" ndotës dhe t'i bashkohen **Përkujdesjes Gjithshqiptare**. Në radhët e Përkujdesjes, si e thamë më lart, do të ketë vend në të gjitha kohët për të gjithë të rikthyerit. Edhe prostituta më shpresëfikur, nëse heq dorë nga pseudozanati i saj, do ta ketë vendin e vet midis atyre që duhet të përkujdesen për të mos i njollosur më as veten, as Kombin e vet. E duam Shqiptarin të mirë! Duam ta kemi Kombin tonë objekt frymëzimi e krenarie, jo objekt turpërimi.

c. PUNËT MBARËKOMBËTARE. Në rend të parë do të jenë **festat** që evokojnë ngjarje të mëdha të Kombit tonë. Ato nuk do të festohen më vetëm prej atyre që **rastësisht** mund të jenë kujtuar **për ndonjë ngjarje që na paska pasur të bëjë me fatet e Kombit**.

Festa e parë dhe më e madhja festë e të gjithë shqiptarëvet do të jetë **28 NËNTORI**. Ajo do të bëhet festë familjare e të gjitha familjevet shqiptare dhe, në një orë të caktuar, në të gjithë sheshet e qytetevet ku banojnë më shumë se 100 shqiptarë, do të ketë nga 1 manifestim festiv. Vlorë, Tiranë, Prishtinë, Shkup, Preshevë, Podgoricë, Janinë. Këta janë të parët qytete, ku nuk duhet asnjëherë të mungojë shkëlqimi i kësaj feste, fatlume për ne shqiptarët. Deri sa të mos ndodhë kështu në të 7-t këta qytete, ne nuk duhet të na zërë gjumi.

Krahas këtyre, **kombinimi aq i bukur kuq e zi,** duhet t'i hijeshojë në këtë ditë të gjithë qytetet e Atdheut tonë: Krujën, Lezhën, Prizrenin, Manastirin, Shkodrën, Korçën, Gjirokastrën, Tepelenën, Memaliajt, Ballëshin, Durrësin, Elbasanin, Beratin, Sarandën, Konispolin, Delvinën, Fierin, Lushnjën, Kavajën, Shijakun, Vorën, Fushë-Krujën, Mamurrasin, Laçin, Milotin, Rrëshenin, Pukën, Fush-Arrësin, Bajram Currin, Kukësin, Krumën, Peshkopinë, Shupenzën, Bulqizën, Burrelin, Klosin, Ulëzën, Peqinin, Cërrikun, Patosin, Kuçovën, Çorovodën, Gramshin, Poliçanin, Këlcyrën, Përmetin, Leskovikun, Ersekën, Maliqin, Pogradecin, Përrenjasin, Librazhdin, Pejën, Deçanin, Klinën, Istogun, Gjakovën, Rahovecin, Malishevën, Skënderajn, Drenasin, Mitrovicën, Vushtrrinë, Podujevën, Kamenicën, Gjilanin, Vitinë, Ferizajn, Kaçanikun, Shtimjen, Lipjanin, Fushë-Kosovën, Therandën, Kumanovën, Tetovën, Gostivarin, Kërçovën, Dibrën, Strugën, Ohrin, Përlepin, Preshevën, Bujanovcin, Ulqinin, Tuzin, Gusinë, Plavën, Tivarin, Tutinin, Rozhajën, Filatin, Gumenicën, Paramithinë, Pargën, Artën, Prevezën, Dhodhonin, Meçovën, Konicën, Kosturin, Follorinën. Në kronikat televizive duhet të thuhet: **Ku u festua më me madhështi Dita e Flamurit dhe ku nuk u arrit të festohej**. Pas kësaj, duhet të jepen edhe kronikat e festimit të kësaj dite në Stamboll, në Athinë, në Bruksel, në Londër, në Njujork e kudo gjetkë, kudo ku gjenden momentalisht a ku jetojnë për gjithnjë mbi 100 shqiptarë. Atje ku ka më pak se 100 shqiptarë, **Dita e Flamurit** do të jetë modestisht festë familjare dhe ndërfamiljare.

Dita e Kosovës, Shpallja e Pavarësisë së Kosovës e 17 Shkurtit, duhet të festohet prapë në të gjithë qytetet që përmendëm (Por jo me flamuj të verdhë**.)**

Dita e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit duhet doemos të përkujtohet të paktën në ata qytete ku ka pasur degë të kësaj Lidhjeje, ndërsa manifestimi qendror, vetëkuptohet, vit për vit këtu në Prizren.

Në **Ditën e Lidhjes Arbërore të Lezhës** duhet të mblidhen përfaqësitë e të gjithë shqiptarëvet në Lezhë. Në ditën e lejimit të

shkollës shqipe, që quhet **Dita e Mësuesit** ose **Dita e Arsimit Shqip**, manifestimi qendror duhet bërë në Korçë. Në **Ditën e Alfabetit** duhet të mblidhen përfaqësi të të gjithë shqiptarëvet në Manastir.

Anembanë Shqipërisë është detyrë e shqiptarëvet (e shqiptarëvet që kanë mbetur gjallë, pa u shfarosur nga masakrat), të organizojnë **ditë përkujtimore** pranë memorialevet, që tashmë i përfytyrojmë të ngritur në çdo vend ku dikush ka dhënë jetën, vetëm e vetëm sepse ishte shqiptar. Për të gjithë këta, duhet të ketë një **ditë të përbashkët përkujtimi**, **Dita e të Rënëvet dhe e të Masakruarvet**, por ne nuk po mund tash të dallojmë, të veçojmë, për nga shkalla e dhimbjes, asnjërën prej tyre: A Ditën e Bihorit, a Ditën e Plavës e të Gisisë, a Ditën e Prekazit, a Ditën e Reçakut, a Ditën e Zajazit, a Ditën e Paramithisë, a Ditën e Tivarit, a Ditën e Borovës, apo ndonjë ditë tjetër të njëjtë si këto?!

Në rastet kur Kombit tonë i bëhen padrejtësi, kur cënohet dinjiteti ynë, qoftë edhe gjoja nga pakujdesia apo gjoja incidentalisht, **Kryesia e Përkujdesjes Gjithshiptare** duhet në radhë të parë të mendojë mirë çfarë duhet bërë, pastaj të veprojë. Mund të mjaftohet thjeshtë me publikimin e ngjarjes apo incidentit. Mund të dilet me deklaratë. Mund të kërkohet që qeveritë të reagojnë, por mund edhe të mos jetë oportune që të reagojnë qeveritë.

Format mund të jenë të llojllojshme, por asnjëherë nuk duhet të ndodhë që një protestë **kombëtare** të përfaqësohet "***prej 5 apo 7 çunavet të Toçit***". Ata kishin të drejtë, por Kombi, për turpin e tij, nuk ishte i përgatitur për t'i përkrahur. Protestat, o do të bëhen siç janë për t'u bërë, o nuk do të bëhen fare. Nëse është për t'iu përgjigjur me demonstrata një ish-presidenti, kur ai deklaron se "***gjysma e tokavet greke ndodhen në shtetin shqiptar***", atëherë demonstratat do të bëhen në ata qytete ku e shohim ne të arsyeshme dhe ashtu siç mendojmë ne se duhen bërë. Nëse është për t'u tallur me një minister të jashtëm, i cili kërkon të drejta për pakicat sërbe inekzistente në Republikën e Shqipërisë, e tallura duhet të jetë e atillë që atij të mos i shkojë më mendja për të bërë

shaka. Nëse duhet reaguar ndaj një pseudoenciklopedie, ai reagim, o duhet të bëjë efekt të atillë që kombi sllavomaqedon të dalë e të kërkojë të tjerë shkencëtarë për enciklopeditë e veta, o lëri në qejfin e tyre.

Duam të themi që reagime do të bëhen. Kur të shihet e nevojshme, do të bëhen edhe demonstrata masive, në të gjithë ata qytete që jo më kot i përmendëm një për një pak më lart. Por ata demonstrime do të bëhen pa zhurma e pa të çjerrura, shumë serioze dhe të rënda, sepse në të gjithë llojet e provokimevet, ne do të na kujtohen dhimbshëm të masakruarit tanë.

Në të tillë demonstrime, në asnjë rast, **shqiptarët nuk do të djegin as grisin flamujt e kombevet të tjerë**. Flamujtë e kombevet nuk janë pronë vetëm të pjesës së tyre të keqe. Ata janë pronë edhe e pjesëvet të mira të atyre kombeve dhe ne na intereson që pjesët e mira të kombevet që na rrethojnë, të jenë me ne e jo kundër nesh.

ç. MË E MADHJA PUNË E PUNËS MË TË MADHE. Nëse e kemi konsideruar si punë tonën më të madhe punën me vetëveten, më e madhja e kësaj pune më të madhe duhet të jetë **SHKOLLIMI NË GJUHËN SHQIPE.** Institucioni i Përkujdesjes Gjithshqiptare ka detyrë të ngulë këmbë në organizimin e vënien në punë të arsimit shqip në të gjithë vendet ku jetojnë arvanitë, arbëreshë dhe shqiptarë. Institucioni i Përkujdesjes Gjithshqiptare nuk është ministri arsimi, por ai duhet t'u kërkojë me insistim ministrivet shqiptare të arsimit që, o të jenë të përkushtuara ndaj kësaj çështjeje, o do të shpallen kombëtarisht si ministri antikombëtare, me demonstrimet më të përshtatshëm për to.

Ke vrarë një njeri? Gjykata të gjykon dhe mbi bazën e atij gjykimi, shpallesh kriminel. Por, nëse ke lënë një njeri pa arsim kombëtar, ti e ke vrarë atë njeri si personalitet (sidomos në kuptimin psikologjik).

Një njeri që nuk shkollohet në gjuhën amtare e që nuk e mëson, qoftë në shkollë, qoftë jashtë shkollës, historinë e kombit të vet, sado

të kompletohet me dituri të tjera, ai rrënjët e identitetit i ka të prera. Është si një degë limoni, e cila, edhe nëse lëshon rrënjë e bëhet pemë, ajo kurrë nuk do të jetë e shëndetshme si limonët e tjerë, të mbirë prej faravet dhe të shartuar në mënyrë të rregullt. Një njeri pa arsim kombëtar është madje më keq se një degë limoni e pangulur në dhe.

Ministritë tona të arsimit nuk kanë të drejtë të vrasin arsimisht asnjë fëmijë të Kombit të vet. Ne, në pikëpamje humane, ashtu siç bën Kisha Katolike, abortin e një foshnjeje e konsiderojmë krim. Të lënët e fëmijëvet të cilitdo komb pa shkollim në gjuhën e vet, s'është tjetër, veçse abort në përmasat e atij kombi. Kur një komb i lë fëmijët e vet në masë pa arsim kombëtar, ai s'bën tjetër, veçse aborton në masë.

Në të gjithë Botën duhet të hapen shkolla shqipe për **të gjithë** fëmijët shqiptarë: Në SHBA, në Kanada, në Australi, në Zelandë të Re, në Angli, në Francë, në Zvicër, në Itali, në Gjermani, në Austri, në Belgjikë, në Hollandë, në Skandinavi, ndoshta edhe në Japoni, në Kore, në Kinë. Por në mënyrën më preokupuese Institucioni ynë i Përkujdesjes Gjithshqiptare duhet të merret me arsimin shqip në shtetet fqinjë me Shqipërinë.

Me Turqinë është tepër e ngutshme të bisedohet, në shkallë shtetesh, që atje të hapen jo 1 apo 10, por qindra shkolla shqipe për diasporën tonë të atjeshme. Nga arsimi parashkollor deri në universitet. Shqiptarët, atje, janë diasporë. Por janë diasporë e madhe, e cila nuk mund të bëjë tjetër, veçse ta shëndoshë Turqinë, ashtu siç e ka shëndoshur në kohën e vet Ataturku.

E njëjta gjë duhet të ndodhë edhe në shtetin grek. Për arvanitët, që janë diasporë, dhe për emigrantët e kohëvet të fundit, që gjithashtu janë diasporë, duhet ngutshëm të fillojnë punën diku rreth 6000 klasa shkollore në gjuhën shqipe. Ndërkohë, për çamët ortodoksë dhe ortodoksët e tjerë, të cilët janë vendës në ato pjesë të Shqipërisë Jugore, që i janë dhënë shtetit grek, duhet të kërkohet status si për të gjitha pakicat joimigruese. Kërkesa e parë e një të tillë statusi, është

regjistrimi civil me kombësi shqiptare dhe me emra shqip, dhe kërkesa e dytë, paralel me të parën, është shkollimi në gjuhën gjyshore.

Në Bullgari, në Rumani, në Bosnjë e Hercegovinë, në Kroaci, në Slloveni, në Itali, aje ku ka një numër shqiptarësh, arbëreshësh apo arbanasësh të mjaftueshëm për një klasë shkolle, atje të hapet dhe të funksionojë një rrjet shkollash në gjuhën tonë.

Për Sërbinë, Malin e Zi dhe për shtetin e sotëm që quhet Maqedoni, si edhe në shtetin grek për pjesët joimigruese, punët e arsimimit të shqiptarëvet mund të trajtohen vetëm mbi argumentin se në ata shtete shqiptarët janë popullsi **konstitucionale**. Kjo do të thotë që **shqiptarët në ata shtete jetojnë në tokat e veta**, pra, bëjnë pjesë në ata shtete jo vetëm si shqiptarë, por edhe si pjesë të Shqipërisë. Të drejtat e tyre janë plotësisht të barabarta me të drejtat e sërbëvet, sllavomaqedonëvet, malazezëvet dhe grekëvet. Ata nuk janë pakica. Ata janë pjesë përbërëse, siç janë gjermanët, francezët dhe italianët në shtetin që quhet Zvicër. (Pavarësisht prej numrit.) Si rrjedhojë, legjislacioni në ata shtete, o duhet të rregullohet si në Zvicër, o shqiptarët duhet të kërkojnë rrugë të tjera.

Në këtë kontekst ne mund të themi vetëm kaq: Mjaft më me qëndrime anakronikë, ksenofobë e shovinistë! Shekulli XXI nuk duhet të jetë shekulli i shovinizmit.

Për të hapur shkolla shqipe e për të funksionuar ato shkolla, duhet një angazhim kolosal. Për të hapur vetëm 1 shkollë shqipe në Paris, Toronto apo Damask, në Janinë apo në Tivar, duhet angazhim kolosal, le më të punosh për të hapur e për t'i mbajtur gjallë në vazhdimësi 20 000 shkolla jashtë kufijvet të 2 shtetevet të sotëm të Shqipërisë. Sa klasa, dmth sa ambiente shkollorë duhen? Sa libra duhen? Sa mësues duhen? Mbi të gjitha, sa propaganda duhet dhe sa përpjekje diplomatike?! Mirëpo ne shqiptarët nuk kemi ndërmend që pasuritë tona kombëtare t'i shpenzojmë as në programet bërthamorë (për të prodhuar bomba atomike), as në pushtimin e Gjithësisë. Ne na duhet gjallërimi dhe përmirësimi i Kombit me anë

të arsimimit. Ne nuk duam të bëhemi fuqi botërore. Ne duam të bëhemi shembull i mirë në Botë.

Virusi i korrupsionit

Në 2 shtetet e sotëm të Shqipërisë, sistemi arsimor ka hasur në probleme të shumtë me natyrë të mirëfilltë gangrenore. Në shkollat tona dhe në universitetet tanë, **sistemi i antiedukimit** po funksionon pësosurisht, në një kohë kur **sistemi i edukimit** ka rënë në një inferioritet të mjerueshëm. Në shkollat dhe në universitetet tanë, **sistemi i antiedukimit** lulëzon, **sistemi i edukimit** vegjeton, pa nxjerrë as lule, as farë.

Ne nuk do të merremi këtu me të gjithë elementët e një të këtillë sëmundjeje (epidemi që s'është vetëm shqiptare), por do të prekim vetëm njërin element: Kopjimin e detyravet dhe provimevet nga ana e nxënësvet dhe e studentëvet. Siç ka virus për të gjitha sëmundjet ngjitëse, kështu ka virus edhe për korrupsionin dhe ky është pikërisht vesi i të kopjuarit. Mundohu sa të duash t'ia heqësh një të rrituri një ves që e ka marrë e pakta qysh prej klasavet të larta të 9-vjeçares! Pedagogjia thotë: Riedukimi është shumëfish më i vështirë se sa edukimi. Një që e ka marrë virusin e të kopjuarit të provimevet fshehurazi, kur të rritet, as domino s'do të jetë në gjendje të luajë pa bërë hile.

Prandaj shkollavet tona vetëvetiu, në procesin e përmirësimit të Kombit, do t'u bjerë një barrë e madhe: Të gjejnë mënyra për të mos u infektuar nxënësit tanë me virusin e korrupsionit.

E morëm këtë si shembull, por sistemi ynë arsimor ka barrë të madhe për të luftuar kundër të gjithë elementëvet të **antiedukimit** dhe për t'i zëvendësuar ata me elementë të mirëfilltë të **edukimit**, human edhe kombëtar. Istitucioni ynë i Përkujdesjes, nuk do të kish për çfarë tjetër të kujdesej, nëse nuk do të kujdesej për arsimin shqip.

Relievi social

Brenda Shqipërisë do të ketë raste me shumicë që veprimet e njërit apo tjetrit të shkojnë kundër interesit të Kombit. Përkujdesja Gjithshqiptare natyrisht që do të mbajë qëndrimin e vet. Ajo do t'u thotë bashkëkombasvet:

Ne nuk jemi kundër pasurimit të cilitdo shqiptar. Shqiptarët le të pasurohen dhe asnjëri prej shqiptarëvet që s'është i pasur, s'ka arsye që t'i ketë zili ata që pasurohen. Në vend të zilisë, smirës, ligësisë, shqiptari jo i pasur duhet të kultivojë te vetëvetja dëshirën për të mësuar shumë e për të punuar shumë, me qëllim që edhe ai të mund të pasurohet.

Ne nuk jemi kundër pasurimit të shqiptarëvet. Përkundrazi, jemi që në Shqipëri të ketë një klasë kapitaliste sa më të fuqishme. Por **jemi kategorikisht kundër çdo metode të rrjepjes së shtetasvet shqiptarë**. Klasa e pasur duhet të kuptojë njëherë e përgjithmonë se **pa klasën e mesme** ajo nuk mund t'i sigurojë vetes as jetë të sigurtë, as jetë të pavarur prej të huajvet, as jetë të gjatë. Në të njëjtën kohë, të pasurit duhet ta kuptojnë që ekzistenca e shtresës së varfër në Kombin tonë nuk i sjell, as Kombit, as vetë klasës kapitaliste, kurrfarë të mire, as ekonomike, as morale, as politike. Prandaj, politikat sociale, të cilat realisht i orientojnë e i kontrollojnë jot ë varfrit, por të pasurit, nëpërmjet parlamentevet, duhet të jenë të atilla që Kombi të mos jetë i pakënaqur prej atyre politikave.

Kombi duhet t'i dojë parlamentarët dhe politikanët, jo t'i shajë ata ditë e natë. T'i kritikojë ata në çdo veprim të tyre jo të drejtë, por jo t'i urrejë. Por kjo varet prej orientimit që do të marrë klasa kapitaliste: A do të marrë orientim në të mirë të Kombit të vet (dhe largpamësisht edhe të vetëvetes), apo do të vazhdojë të jetë egoiste, e korruptuar, e shitshme te të huajtë (dhe shkurtpamësisht kundër vetëvetes)?

Përfundimisht, pikësynimi i Përkujdesjes Gjithshqiptare do të jetë që relievi ynë social të jetë i atillë që ai të mos mund të bëhet shkak për kurrfarë zgjatje duarsh të të huajvet drejt pasurivet tona dhe drejt tokavet tona. Përgjegjësia në këtë aspekt i bie tërësisht klasës sonë

të pasuruar. Klasat e mesme dhe të varfëra nuk caktojnë dot deputetë apo ministra. Deputetët dhe ministrat i caktojnë të pasurit. Klasat e mesme dhe të varfëra zgjedhin, midis deputetëvet që caktojnë të pasurit, ata që janë më të pranueshmit. Kriteri është: **Dëshmohuni atdhedashës, ndryshe, herën tjetër nuk do të votojmë për ju!**

Kaq mund të bëjnë zgjedhësit. Por Autoriteti i Përkujdesjes Gjithshqiptare duhet t'i gjejë mundësitë për të bërë shumë më tepër.

Zbukurimi i tokës së shqiptarëvet

Po shihet tashmë gjithandej që meraku ynë më i madh është: **Përmirësimi i individit shqiptar**. Vetëm nëse do të arrijmë që t'i kemi shumicën e shqiptarëvet njerëz pozitivë, (që ai prifti i shitur të mos mund të thotë më: ***Këtu prindi vret fëmijën, gruaja vret burrin e burri vret gruan***!), vetëm nëse arrijmë të kemi mësues të virtytshëm e dinjitozë, mjekë të virtytshëm e dinjitozë, juristë të virtytshëm e dinjitozë, parlamentarë të virtytshëm e dinjitozë, ministra të virtytshëm e dinjitozë dhe kryeministra e presidentë gjithanësisht të respektueshëm, vetëm atëherë ne do të mund të shpresojmë që Kombi ynë nuk do të pësojë më kasapime e shkrumbime, si në Bihor, Plavë e Gusi, dhe vendi ynë nuk do të pësojë më copëzime e stërcopëzime, si në paloshtetin e vitit 1914 të Esatpashës.

Por krahas asaj që ne ta rrisim përditë numrin e shqiptarëvet edukativisht dhe moralisht të zbukuruar, duhet punuar më shumë se përditë për të zbukuruar **tokën e shqiptarëvet**.

Janë përdorur shprejet "***atje i kam ment e mija" "lum kush t'rronjë, ta shohë zonjë***" "***ta bëjmë Shqipërinë kopësht me lule***", por ne do të themi: ***Ta bëjmë Shqipërinë të atillë, që ne vetë të mos vështrojmë për të ikur këndej, por t'i krijojmë vetes të gjitha mundësitë për të jetuar këtu!*** Po s'e bëmë ne Shqipërinë, s'ka për të ardhur dikush tjetër e ta ndërtojë për ne. Ai i huaji, në ardhtë (dhe

s'janë të pakët ata që lakmojnë), kanë për ta bërë këtë vend për ata, jo për ne.

PËRBASHKËSIA EKONOMIKE

Institucioni i Përkujdesjes Gjithshqiptare duhet të ketë një sektor të informimit e të propagandës për bashkëpunimin ekonomik midis shqiptarëvet. Institucioni i Përkujdesjes Gjithshqiptare nuk është as ministri e ekonomisë, as dhomë tregtie, por megjithkëtë ai është i thirrur që të kujdeset për këtë anë të jetës së Kombit, si për njërin prej aspektevet më të rëndësishëm të ekzistencës së tij. Kombi është bashkësi kulture, bashkësi tradite, bashkësi gjuhe, bashkësi prejardhjeje, por **kombi është edhe bashkësi EKONOMIKE.** Nëse nuk do të kish nevojë për një bashkësi **EKONOMIKE**, kombit s'do t'i duheshin gjë as shteti, as partitë politike, as sistemet e mbrojtjes, madje atij s'do t'i hynte shumë në punë as vetë atdheu. **INTERESAT EKONOMIKË** janë ata që, krahas kulturës, gjuhës, prejardhjes etj, e përforcojnë edhe më shumë përbashkësinë e një kombi.

Bashkëpunimi e bashkëveprimi **EKONOMIK** i shqiptarëvet në sh XXI duhet të jetë themeli i suksesit e i përparimit të tyre. Askush deri më sot nuk e ka nxjerrë në shesh, nuk e ka bërë të dukshme, sa shumë energji në pikëpamje **EKONOMIKE** kanë shqiptarët dhe sa po u shkapërderdhen ato energji, si ujërat që nuk kalojnë nëpër turbina.

Sektori informativ i **EKONOMISË** pranë Institucionit të Përkujdesjes Gjithshqiptare duhet të ketë një skedar të gjërë të subjektevet **EKONOMIKË** shqiptarë, kudo që ata ndodhen, në Atdhe ose në Botë. Me anë të një të tillë skedari informues do të mund t'u shërbehet ministrivet përkatëse, dhomavet të tregtisë, bankavet, organizatavet të ndryshme të emigrantëvet, shoqatavet të ndryshme të punëkërkuesvet.

Kapitali që grumbullon një biznesmen shqiptar i suksesshëm në Amerikë, në Angli, në Gjermani, në Australi, duhet të gjejë rrugët për t'u shtuar edhe më shumë pikërisht këtu në Atdheun tonë. Kushti që një kapital i grumbulluar diku jashtë, të shumëfishohet këtu në

Atdhe, është që zyrarët e këtushëm të jenë atdheekombdashës para se të jenë atdheekombrrjepës. Pikërisht këtu duhet të përqëndrohet Përkujdesja. Pasi të ketë hyrë kapitali lirshëm në Atdheun tonë, pa u ngërthyer e mbërthyer nga telat me gjemba të korrupsionit grykëkuçedër, edhe vetë aspiruesit e korrupsionevet do ta shohin që edhe për ata do të jetë më mirë.

Në një tjetër vështrim, bashkëlidhja **EKONOMIKE** midis shqiptarëvet që e zhvillojnë veprimtarinë e vet brenda Atdheut, dmth brenda 6 shtetevet ku jetojnë shqiptarët, do të mund t'i sjellë Kombit tonë jo më thërrime të të mbijetuarit, por ringjallje të mirëfilltë dhe ngjitje deri në nivelin e cilitdo popull të Evropës.

Do të vijë ashtu një ditë, madje shumë shpejt, kur **EKONOMIA** jonë nacionale do t'i investojë kapitalet e vet edhe jashtë Shqipërisë, në Azerbajxhan, në Kanada, në Honduras, në Brazil, në Eritre, në Algjeri, në Egjipt, në Siri, në Iran, në Liban, në Rusi, në Ukrainë e në Spanjë. Shqiptarët janë njerëz shumë të zotë. Mjafton që të ruhen nga të harruarit që janë e që duhet të jenë më parë shqiptarë, pastaj qytetarë Botës. Institucioni ynë i Përkujdesjes duhet të luajë rolin e nënës ndaj të këtillë bijve të Kombit tonë.

Ka qindra mijë shqiptarë që kërkojnë punë dhe nuk u jepet kurrfarë mundësie institucionale për ta gjetur një punë. Përkujdesja duhet të mbajë lidhje me sa më shumë agjensi punësimi në mbarë Botën dhe t'ua rekomandojë të papunëvet të vet vendet e punës. Këtë punë duhet ta kryejë si Kryesia në qendër, pra në Prizren, ashtu edhe grupet përkujdesës, që është paramenduar të ndodhen gjithandej. Këtu përsëri ky institucion duhet të luajë rolin e nënës. Ne nuk mund t'i lëshojmë të rinjtë tanë malevet e detravet, sikur të jemi raca më inferiore. Ne nuk na lejohet ta braktisim rininë që të na mbytet detravet ose të mbushë burgjet e botës.

Një ministri, qoftë edhe një tufë ministrishë, kështu si na ka lënë historia ne, të shpërndarë nëpër 6 shtete, po edhe të mbjellur nëpër Botë, sado që ato i kanë detyrat e veta, nuk do të mund ta kryenin kurrë punën gjithkombëtare, në formën që atë e kryen Institucioni i

Përkujdesjes. As dhomat e tregtisë, sado punë të mirë të bëjnë ato, brenda kornizavet dhe mundësivet të veta, kurrë nuk do të mund t'i plotësonin kërkesat e ndëlidhjevet **EKONOMIKE** midis të gjithë shqiptarëvet apo këkesat e punësimit. Psh problemin e një arbëreshi apo të një shqiptari emigrant, mbetur pa punë diku në Sicili, asnjë ministri apo dhomë tregtie nuk besojmë të mund ta zgjidhë. Me të këtillë halle jetojnë nja 2 apo më shumë milionë shqiptarë, 1 këtu e 1 atje, 5 këtu e 7 atje. Institucioni i Përkujdesjes Gjithshqiptare, nëse punon vërtet si i tillë, shumicën e këtyre punëve do të mund t'i aranzhonte.

Me këso veprimtarishë kombeatdhedashëse vërtet do të mund të shihnin ditë më të mira të gjithë ata shqiptarë që **duan** të punojnë, por edhe vetë Atdheu ynë do të zbukurohej prej veprash të të gjitha degëvet të ekonomisë.

Ne nuk jemi ksenofobë, prandaj në të gjitha ndërmarrjet **EKONOMIKE**, qoftë të të kamurvet tanë, qoftë të punëkërkuesvet, Përkujdesja Gjithshqiptare nuk do të predikojë mbyllje në vetëvete. Ne do të bashkëpunojmë me të gjithë kombet.

Të vetmet kërkesa tonat do të jenë: Të mos na përdorin të huajt si vegla e si shërbëtorë faqeleckë, të mos na ia thithin gjakun të huajt **EKONOMISË** sonë, përkundrazi, të jemi të paktën të barabartë në pëfitimet **EKONOMIKË**, të mos lejojmë depërtimin në vendin tonë të mallravet skarco "***bono per Albanesi***", se është turp e ulje skandaloze, të mos e pushtojnë të huajt tokën tonë "***paqësisht***" nëpërmjet lidhjevet **EKONOMIKE** me individë të ndryshëm ose me pushtetarë, të mos ua shesim të huajvet resurset… Rrotull nesh ka shumë të atillë që dinë ta përdorin shkëlqyeshëm metodën e qyqes: I lëshojnë vezët në çerdhe të zogjvet të tjerë, zogjtë e tjerë naivë i ngrohin e i çelin ato vezë, më në fund, qyqet e vogla i nxjerrin me krahë dhe i hedhin poshtë në livadh të zotët e vërtetë të çerdhes. Me këtë lloj metode na janë marrë një pjesë e madhe e tokavet tona. Me po këtë metodë, nëse nuk do të rrimë syçelët, **në periudhën pas hyrjes sonë në BE**, ka rrëzik të na e zaptojnë Shqipërinë zaptuesit e

kahmotshëm. Këta 15 a 16 rreshta do të duhej t'i rilexonin çdo ditë të gjithë shqiptarët.

NATYRA, TOKA E SHQIPËRISË

Bukuritë e vendevet ku jetojnë shqiptarët janë të atilla që, edhe kështu të papërkujdesura, i lënë pa mend njerëzit që i shohin. Ata që dinë t'i shohin! Relievi, bimësia, uji, ajri, deri edhe qielli i Shqipërisë është i magjishëm.

Merr cilin të duash kënd të vendit tonë. Lëre formën relievore ashtu siç është, bëj një ndërtim shtesë në harmoni me atë formë, plotësoje me bimë, shtoji zogjtë, peshqit, bagëtitë, si element dekorativ, zhduki mushkonjat, karkalecat, dhe çdo insekt të bezdisshëm, mos tolero të ketë njerëz të ligj rretherrotull, cinikë, hajdutë, imoralë, arrogantë, pijanecë, zhurmamëdhenj, mburravecë, injorantë dhe përtacë, dhe e ke bërë Shqipërinë një parajsë, ku të gjithë të gjallët e Botës do të dëshirojnë të vijnë të paktën 1 herë në jetë.

Do punuar e do menduar përditë për zbukurimin e kësaj toke. Rrugët dytësore e tretësore, ambientet përpara shtëpivet e rrotull shtëpivet, prerje e pastrim shkurresh anash rrugëvet, ruajtje e drurëvet kudo ku ata mund të kenë mbirë vetë, mbjellje drurësh jo vetëm anash rrugëvet, por kudo ku shihet e nevojshme se mund dhe duhet të ketë një pyll, mbjellje, por edhe ruajte e drurëvet, sepse, sado të mbjellësh, po nuk i ruajte, ata nuk bëhen asnjëherë, ndëtim pritash, që toka të mos gërryhet, ndërtim çesmash dhe kronjsh (siç i përshkruan Lasgushi) në të gjithë ambientet, por sidomos pranë rrugëvet, moslejim i asnjë lloj ndotjeje (ndotje me mbeturina plastike, ndotje me ujëra të zez, ndotje me hedhurina metalike e me inerte, ndotje me anë të industrisë së pakontrolluar), moslejim i dëmtimit të peshqvet dhe kafshëvet, nxitje për kultivim e bukurtrajtim të lulishtevet. Janë me mijëra punë që duhen bërë, me qëllim zbukurimin e këtij vendi, por janë me mijëra dëmtime të një pjese të bashkëkombësvet tanë, me të meta mendore, të cilët duhen ndalur. Mirëfilli, me të meta mendore!

Shumë gjëra, për ta pasur Atdheun të bukur, mund të bëhen me vullnet, me dëshirë, me sedër kombëtare. Por sedra kombëtare ka nevojë të nxitet prej dikujt. Sedra kombëtare ka nevojë të kthehet në opinion zotërues. E dimë tashmë se cilën tokë quajmë ***TOKË SHQIPTARE***, por kjo duhet përësëritur shumë herë. Quajmë ***TOKË SHQIPTARE*** të gjithë hapësirën gjeografike ku shqiptarët banojnë historisht. Pra, quajmë ***TOKË SHQIPTARE*** tokat që përfshihen në Republikën e Shqipërisë, tokat që përfshihen në Republikën e Kosovës, tokat që përfshihen në veri e veriperendim të shtetit grek, tokat që përfshihen në Republikën e Maqedonisë, ato që banohen edhe me shqiptarë, tokat që ndodhen në Republikën e Sërbisë e që ne e quajmë Anamoravë dhe tokat që përfshihen në shtetin malazias, por që banohen me shqiptarë. Pa marrë parasysh se në cilin shtet ndodhen këto toka, ne duhet të punojmë në atë mënyrë që këto të dallohen **PËR MIRË**. Pra, të njihen se janë **TOKA SHQIPTARE**. Kur një i huaj hyn në këto toka, ai ta kuptojë se ka hyrë në atdheun e një kombi të kulturuar. Të mos lidhen shëmtueshëm

telat elektrikë, të mos ndehen rrobat nëpër ballkone, që t'i shohin sutjenat e brekët e gravet tona kalimtarët, të mos jenë të shëmtuar gjerdhet dhe portat e oborrevet nëpër fshatra, të mos digjen pyjet e kullotat, se e shëmtojnë Shqipërinë. Zjarrvënësit dhe dëmtuesit e pyjevet edhe në varr i ndjek e s'i lë të qetë mallkimi.

TOKA SHQIPTARE quhen edhe ato pjesë të Shqipërisë, të cilat, filluar nga viti 1877 e këndej, gradualisht janë zëvendësuar me popullsi të tjera, sllave ose greke. Për zbukurimin edhe të atyre tokave, ne tashmë nuk kemi gjë në dorë. Por duhet thënë një e vërtetë, që është shumëfish e hidhur: **Ato toka, ATA TË TJERËT i mbajnë më mirë se ç'i mbajmë ne këto që s'na i kanë marrë**. Ka ardhur koha që sedra jonë të gërvishtet ndijshëm. Të na skuqet lëkura e faqes!

BUJQËSIA, ZBUKURUESJA E DHEUT

Ka ardhur koha që bujqësinë ta modernizojmë jo veç për ekonomi, por edhe në funksion të zbukurimit të vendit tonë.

Sot për sot, bujqësia jonë, më mirë të themi ***PABUJQËSIA*** jonë, i ka dhënë Dheut tonë një fytyrë të shëmtuar. I tronditur për dekada të tëra prej këtij lloj shëmtimi, autori i këtyre parashtrimeve ka menduar gjatë se çfarë bujqësie do t'u shkonte më për shtat shqiptarëvet dhe tokavet të Shqipërisë. Çfarë bujqësie do t'u përshtatej shqiptarëvet, që ata të mos e përbuzin dhe të mos e braktisin atë, siç e kanë braktisur. Sigurisht që mbi këtë problem ka shumë të tjerë që kanë menduar, por ne po japim mendimin tonë.

Vendit tonë nuk i shkon një bujqësi me prona qindra e mijërahektarëshe. Ne nuk kemi hapësira të atilla, siç i kanë psh Rusia, Kanadaja, SHBA-ja, Australia. I kemi pasur çifligjet e bejlerëvet dhe ata ishin aq anakronikë, sa e çuan krejt vendin në shkatërrim. I kemi pasur edhe kooperativat e tipit të lartë. Edhe ato e çuan vendin në shkatërrim. Në pjesë të tjera të Shqipërisë, me pronat bujqësore kanë luajtur pushtuesit siç u ka dashur atyre qejfi. Mirëpo, ne nuk na shkon as një bujqësi që të jetë e grimcuar, e ndarë

në prona të vogla 2-dynymëshe, 5-dynymëshe apo edhe 2-hektarëshe. Nuk na përshtatet një copëzim i këtillë, thjeshtë sepse nuk i del hesapi fshatarit të merret me atë punë në aq pak tokë. Prandaj ne mendojmë që **prona bujqësore në Shqipëri duhet të shkojë gradualisht drejt rrumbullakësimit rrotull 10-hektarëshit.**

Institucioni i Përkujdesjes Gjithshqiptare duhet të propagandojë, me argumentet përkatës të përimtuar, pikërisht pronat 10-hektarëshe. **Bankat duhet t'i stimulojnë me kredi të posaçme të këtilla prona**. Ato duhet të kreditojnë blerjen e sipërfaqevet deri në 10 hektarë (jo më shumë), pajisjen me mjetet e mekanizimit, rrethimin e tyre (si dikur në Angli, por me rrjetë teli, jo me gardh të kalbshëm) dhe vënien e tyre në punë. Kthimi i paravet do t'u garantohej bankavet nga vetë pronat e krediuara, siç bëhet zakonisht me kreditë e shtëpivet. Nëse kredimarrësi nuk i shlyen kështet, toka i mbetet bankës për t'ia shitur dikujt tjetër.

Pronat 10-hektarëshe i japin mundësi fshatarit për të zbatuar metoda bashkëkohore në të gjithë punën e tij.

A) Të paguajë disa specialistë (agronom, veteriner, ekonomist, jurist) me nga 1/20-ën e pagës. (Secili prej këtyre specialistëve mund të mbajë 20 ferma të tilla).

B)Të përdorë në pronën e vet mjete të mekanizuar: traktor të vogël, prashitëse, korrëse, paketuese bari, pompa spërkatëse, pompa ujitjeje, rrjet tubacioni, serë etj.

C) Të përdorë herbicide, pesticide dhe plehra kimikë në mënyrë të rregullt.

Ç) Të mbajë bagëti (4 lopë, 20 dhen, 7-8 dhi, 50 pula, rosa dhe pata) të cilat të mund t'i sigurojnë atij plehun e nevojshëm organik, me qëllim që prodhimet e tij bujqësorë të jenë të cilësisë "***bio***" në shkallën më optimale.

D) Të organizojë në pronën e vet një qarkullim bujqësor sa më të përshtatshëm, por të ketë edhe pemë gjithfaresh (hardhi, fiq, agrume, mollë, ftonj, dardha).

DH) Të mund të paguajë, në kohë piku, punëtorë me mëditje.

E) Të sigurojë kontrata shitjeje në kohë dhe me garancinë e nevojshme.

Ë) Të mund t'i **shkollojë** fëmijët e vet normalisht, si të gjithë shtetasit e tjerë.

F) Të mund t'i paguajë shtetit taksat në mënyrë të rregullt.

Vetëm në këtë mënyrë fshatari ynë do të mund të quhet ***fermer*** në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Do të mund të krijohet kështu në Shqipëri një **klasë fshatare e mesme**, e cila do ta normalizonte shoqërinë tonë në shumë aspekte. Institucioni i Përkujdesjes Gjithshqiptare një të tillë klasë do ta kish mbështetur me të gjithë mjetet. Dmth me gjithë shpirt.

Meqë jemi te kreditimet bankarë, t'i themi edhe disa fjali në relacionin **TOKA DHE UJI**. Kreditimet e objektevet madhorë, të cilët në kohë thatësire i çojnë tokës ujin e në kohë reshjesh e mbrojnë tokën prej përmbytjesh, shembjesh e gërryerjesh, i organizojnë dhe i zgjidhin qeveritë. Bankat edhe këtu doemos e kanë rolin që u takon. Por në përpjesëtime më të vegjël, në përshtatje me kushtet e çdo grupimi fermash, (në vizionin tonë, jo më të mëdha se 10-hektarëshe), bankat do të mund të kreditonin edhe **ngjitjen e ujit** nga baza (lumenj, liqene, kanale) në pikat dominuese të tokavet. Kredimarrësi do ta kish pronë të vetën një të tillë ujëngjitës dhe ai do t'i nozullonte me sasitë e nevojshme të ujit fermat rretherrotull, me të cilat, natyrisht, do të kishte kontratat përkatëse. Të tillë **ujëngjitës** do të mund të instaloheshin në vendin tonë disa mijëra. Një tjetër kreditim "*të vogël*" do të mund të bënin bankat për ndërtimin e **ujëmbledhësvet familjarë**. Në Shqipëri ka qenë traditë ndërtimi i të tillë ujëmbledhësvet ose **ujëgrumbulluesëvet** dhe ata quheshin ***hurdha*** ose ***hauze***. Por tani bëhet fjalë që ata të jenë prej

betoni, me kapacitet e kosto të studiuar mirë: 1000m^3, 5000m^3 ose edhe më pak, psh 200m^3, 150m^3 etj. Kërkesat për rezervuarë të tillë do t'ishin aq të shumta, sa vetë presidentët e bankavet do të çuditeshin. **Shqiptari** duhet të shikojë perspektivë, duhet të shikojë që ka të ardhshme, dhe ai është **jashtzakonisht aktiv**. Shqiptari është iniciator. Vetëm kur s'ka çka bën, shdërrohet në keqbërës (në radhë të parë të vetëvetes).

KUJTESA HISTORIKE

Në tokën shqiptare ka nevojë të evidentohet vizualisht historia. Ç'duam të themi me "***të evidentohet vizualisht***"? Duam të themi që kalimtari të ketë mundësi t'i shikojë me sy ngjarjet që kanë ndodhur këtu në të gjitha kohët, dhe kjo arrihet duke ndërtuar **memoriale**. Shkëmbinj të mëdhenj me nga një tekst të gdhendur në ta, sajesa prej betoni, të formatuara në gjithfarë pamjesh e dimensionesh, në të cilat të mund të lexohet nga një tekst, pllaka mermeri, jo gjithmonë, madje pothuaj asnjëherë katërkëndëshe, sajesa metalike (bronx, gizë, inoks, llamarinë e zakonshme), sajesa të shumëllojshme qeramike, trungje drurësh, të trashë e të mëdhenj, trajtuar në mënyrë që të mos kalben. Dhe shih ç'mund të gjejë kalimtari në të këtillë **objekte përkujtues**! "*Këtu ka fjetur një natë Johannes Georg von Hahni në vitin 1858." " Këndej ka kaluar me një ushtri të madhe sultan Mehmeti II në vitin…" " Ky është vendi ku ka bërë bisedime me përfaqësuesit ilirë pretori romak Anici, në vitin…" " Në vitin 1702 ka bujtur këtu arqipeshkvi Vinçenc Zmajeviqi." " 100 m më lart ndodhet një shpellë karstike." " Në v 1943, këtu partizanët shqiptarë u kanë bërë pritë italianëvet." " Në vitin 1944, po në këtë vend, ka ndodhur një luftim midis ushtrisë partizane shqiptare dhe një kompanie gjermane." " Ky është vendi ku dikur është kultivuar mëndafshi." " Në këtë krahinë ka një racë qensh që njihet me emrin qeni i Sharrit." " Në këtë trevë kultivohet fiku me emrin fuku i Tivarit." " Ky vend kultivon rrushin që quhet rrush Cëruje". "Vizitoni ujërat termalë që njihen me emrin (kështu)." " Këtu është vrarë Atë Shtjefën Gjeçovi." " Këtu ka jetuar Hasan Zyko Kamberi." " Këtë pjesë të*

Shqipërisë e ka sunduar, në Epokën e Ilirëvet, mbreti (filan).” “ Këndej ka kaluar ushtria e Agronit.” “ Këtu është rrëzuar një avion sërb.” “ Ky është vendi ku ka jetuar Ndre Mjeda.” “ Në këtë vend janë ndeshur Mark Antoni dhe Jul Cezari.” “ Këtu është vrarë Xhevdet Mustafa.” “ Këtu është kapur Hamit Matjani.” “ Këndej ka kaluar Ahmet Zogu, kur ka rrëzuar qeverinë e Fan Nolit.” “ Këtu ka lindur Mehmet Shehu.” “ Kjo ka qenë shtëpia e Hivzi Sulejmanit.” “ Këtu ka punuar Esat Mekuli.” “ Këtu është zënë rob Moisi Golemi.” “ Këndej ka ardhur ushtria e Gjergj Kastriotit kur ka rrethuar Drishtin.” “ Këtu kanë pasë kuvendin françeskanët, nga v (kaq) deri në v (kaq).” “ Në këtë vend janë vrarë 5 komunistë, që më vonë u quajtën Herinjtë e Vigut.” “ Këtu ka lindur atë Gjergj Fishta.” “ Ky është fshati i Selam Musait.” “ Këtu ka jetuar Marko Boçari.” “ Në këtë krahinë rriteshin gjedhë të një race të veçantë me brirë të gjatë në Epokën e mbretit Pirro.” “ Kjo ullishtë është më se 2000-vjeçare.” “ Këtu është vrarë Balsha II.”

Kur të mbushet Shqipëria me të këtillë përkujtues, turistët nuk do të mund të ecin më me makina. Ata do të detyrohen të udhëtojnë më këmbë nëpër Shqipëri. Dhe, krejt këto punë, nuk do të mund të kryheshin kurrë pa **INSTITUCIONIN E PËRKUJDESJES GJITHSHQIPTARE.**

(Marrë nga libri: GJOKË DABAJ: “*STRATEGJIA E SHQIPTARËVET*”, Tiranë 2011, f.214-259, me disa ndryshime)

* * *

Tiranë, 21 gusht 2013: Gjokë Dabaj, autori i librit "Strategjia e Shqiptarëvet", gjatë takimit me kryeredaktorin e pashtriku.org, Sheradin Berisha.

ASKUSH TË MOS MENDOJË SE ËSHTË LEHTË

GJOKË DABAJ

Para disa ditësh u publikua te "***Pashtriku***" një shkrim i imi lidhur me domosdonë e krijimit të INSTITUTIT TË PËRKUJDESJES GJITHSHQIPTARE. Është e njëjta ide që e kam shtjelluar edhe në librin "***Strategjia e shqiptarëvet***". Sipas informimit që më erdhi prej kryeredaktorit të portalit "***Pashtriku***", z.Sheradin Berisha, një numër jo i vogël lexuesish është shprehur se shqiptarëvet vërtet u duhet një i tillë organizim dhe unë tani po shpresoj që kjo nismë një

ditë edhe mund të sendërtohet. Natyrisht, nëse ekziston vullneti i pjesës më të vetëdijshme dhe më pozitive të Kombit tonë.

Për të kuptuar sa i nevojshëm është ky institucion i yni, po edhe çfarë sakrificash këkohen, unë po rendit këtu edhe disa sqarime, të cilët, me këtë rast, njerëzit tanë vullnetmirë duhet t'i kenë në vëmendje. Askush nuk duhet të mendojë se krijimi dhe sidomos funksionimi i asaj që unë e kam quajtur PËRKUJDESJA GJITHSHQIPTARE, është një punë e lehtë. Naum Veqilharxhin e kanë helmuar, se deshi të shkruhej gjuha shqipe. Papa Kristo Negovanin e masakruan, se hapi shkollë shqipe. Petro Nini Luarasin e helmuan. Atë Shtjefën Gjeçovin e vranë, jo se ishte prift, por sepse kish hapur shkollë shqipe. Ndrecë Ndue Gjokën e vranë, jo sepse ishte komunist (Ai nuk qe komunist.), por sepse hapi shkolla në Mirditë.

Autorin e këtyre radhëve, shqiptarët e Tivarit nuk do ta kishin lejuar kurrë të hapë shkollë shqipe në Tivar. Prandaj dhe u detyrua të kërkojë rrugë të tjera.

S'ka shumë kohë që, një ish-meshtar të dioqezës së Tivarit, Dom Nikson Shabanin (sipas dëshmisë së atij vetë), e kanë keqtrajtuar, sepse donte t'ua mësonte fëmijëvet shqiptarë lutjet ***Ati ynë*** etj. në gjuhën shqipe. Janë mbledhur 200 shqiptarë dhe i kanë thënë: "***Na nuk duom qi ti me u suo thmivet tonë uratat n'giuhën shqype***." Mbledhja ka zgjatur shumë. Është bërë zhurmë e madhe. Por, në fund, "***arsyetimi***" ka qenë ky: "***Pse nuk doni që fëmijët tuaj t'i thonë shqip lutjet, ashtu siç i kanë thënë edhe gjyshet e tyre***?" Shqiptarët e Tivarit janë përgjigjur kështu: "***Se ti kshtu po do me na pru Sqypninë e Malle ktu n'Tivar***." Shtyrë nga të këtillë "incidente", janë detyruar, me sa duket, autoritetet e kishës, e kanë hequr Dom Niksonin prej Tivarit dhe e kanë çuar në Prizren. Aty, të paktën

besimtarët nuk i thonë: "***Po do me na pru Shqipninë e Madhe***". Mirëpo, pa të provojë dikush me i ngritë në qendër të Prizrenit, te Shatërvani, një monument Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ashtu siç e ka Vlora në qendër të vet Monumentin e Pavarësisë! Ose një monument të UÇK-së. A do t'i lejojë kush?! Në periferi e nëpër qoshe mundet, por në qendër, jo, sepse aty, "me ligj" nuk lejon Sërbia. A ka më zi e më keq?!

Pikërisht këto, e shumë e shumë të tjera, janë arsyet që na shtyjnë të mendojmë se shqiptarëvet u duhet INSTITUCIONI I PËRKUJDESJES, sado sakrifica të kërkojë ai INSTITUCION. Organizimi i INSTITUCIONIT TË PËRKUJDESJES GJITHSHQIPTARE është, pra, i kushtëzuar nga gjendja faktike, reale, e sotme, e Kombit Shqiptart. Por, edhe sikur të mos e kishim këtë gjendje, në përgjithësi përkujdesja kombëtare e cilitdo komb, sidomos në kushtet aktualë të globalizmit, është kërkesë e kohës.

PARAKUSHTET - PARASHTRIM I SHKURTËR

I) Përkujdesja Gjithshqiptare nuk mund të jetë SHTETËRORE, ndonëse pushtetarët, drejtuesit e shtetit të të gjithë nivelevet, duhet të jenë anëtarë të Përkujdesjes dhe ta ndihmojnë atë, edhe personalisht, edhe shtetërisht (sidomos financiarisht), me të gjitha mënyrat. Përkujdesja nuk mund të jetë shtetërore, midis tjerash, edhe sepse Kombi ynë jeton në shumë shtete. Madje, ai jeton në një numër të madh shtetesh, sepse, përveç Atdheut, që e kemi të copëzuar në 6 shtete, Kombi ynë ka edhe një mërgatë aq të madhe, sa ajo e kalon disa herë numrin e shqiptarëvet që jetojnë në Atdhe. Rrjedhimisht, cilido pushtetar, i çfarëdo niveli qoftë, sado që të dëshirojë për të kontribuar në mbarëvajtjen e Kombit të vet, ai prapëseprapë e ka të lidhur punën e vet me një shtet të caktuar. Psh.

një kryeministër i Rep.së Shqipërisë, mund dhe duhet të interesohet për mbarëvajtjen e shqiptarëvet në Çamëri. Por ai kurrsesi nuk mund t'i ketë në fokusin e punës së vet, as juridikisht, as financiarisht, njësoj, si Delvinën që është pjesë e Çamërisë brenda Rep.së Shqipërisë, si Filatin, që gjendet jashtë Rep.së Shqipërisë. Një pushtetar shqiptar në shtetin turk, nëse është i formuar kombëtarisht, doemos që duhet të punojë në të mirë të shqiptarëvet, por funksionalisht ai është në shërbim të shtetit turk dhe kjo s'ka si t'i mohohet. Një të tillë shqiptari, psh, kryebashkiakut të një njësie administrative të Stambollit, nuk mund t'i kërkohet që në programin e vet të punës të ketë edhe zhvillimin e arsimit midis arbëreshëvet të Italisë. Një pushtetari shqiptar në Rep.e Malit të Zi, natyrisht, i takon të punojë për mbarëvajtjen e jetës së shqiptarëvet në atë shtet, por atij nuk mund t'i kërkohet që, në programin e punës së vet, të ketë përfshirë, ta zëmë, edhe urbanistikën e Elbasanit apo të Ferizajt. Në këtë kuptim, pa qenë nevoja të rendisim tani edhe qindra shembuj të tjerë, po themi që Përkujdesja Gjithshqiptare nuk mund të jetë ekskluzivisht në dorën e ndonjë shteti, qoftë edhe të të quajturit ***shteti amë***. Përkujdesja Gjithshqiptare, pra, duke qenë ekstrashtetërore, jashtështetërore, duhet të përfshijë brenda përkujdesjes së vet çdo shqiptar, në cilindo shtet që të ndodhet. Asnjë organizëm tjetër nuk do të mund ta bënte një punë të këtillë, përveç nëse shqiptarët do të kishin një fe të vetme dhe ajo të ishte rigorozisht e pavarur dhe rigorozisht autoqefale shqiptare (gjë që, për fat të keq, nuk ka ndodhur asnjëherë).

II) Përkujdesja Gjithshqiptare nuk mund të jetë PARTIAKE, ndonëse çdo anëtar i cilësdo parti shqiptare, por edhe çdo shqiptar që është anëtar i ndonjë partie joshqiptare, duhet të jetë pjesëtar i Përkujdesjes dhe ta ndihmojë atë me të gjitha mënyrat. Përkujdesja

Gjithshqiptare nuk mund të jetë partiake, sepse në Kombin tonë ka shumë parti, të cilat nuk e unifikojnë Kombin, përkundrazi, e parcializojnë. Kjo nuk do të thotë që ideatorët e Përkujdesjes janë kundër ekzistencës së partive. Ato le të ekzistojnë, ato le të punojnë për interesat dhe qëllimet që i kanë në programet e vet, sigurisht, edhe për interesat e kombit, të cilit i përkasin, por, duke qenë jo TËRËSI, por PJESË (Krahaso lat. PARS, PARTIS, pjesë.), kujdesin për krejt Kombin tonë asnjëra prej tyre nuk mund dhe nuk ka të drejtë ta marrë përsipër. Shembuj: Në Rep.e Kosovës, asnjëra nga partitë e atjeshme nuk mund të bëjë fushatë elektorale mbi premtimet se çfarë do të bëjë, ta zëmë, lidhur me zhvillimin e bujqësisë në Myzeqe. BDIU-ja (Partia për Bashkim, Drejtësi, Integrim e Unitet), sado që programin e vet e ka nacional, ajo nuk mund të marrë as edhe një çerek deputeti, ta zëmë, prej çamëvet të Izmirit, të cilët në numër janë disa herë më shumë se çamët e Tiranës. E le të mos flasim për votuesit e Preshevës. BDIU-ja atje nuk ka mundësi juridike për të marrë votat. Të njëjtën gjë mund të themi për AK-në (Aleancën Kuqezi), të cilën mendojmë se e kemi përkrahur me të drejtë. Flamurin e Kombit tonë ajo mund ta çojë në Tetovë (dhe mirë bën), mund të arrijë një ditë ta shpalosë edhe në Artë. Mund të bëjë shumë gjëra dhe duhet të bëjë, por vendet në parlament ajo do t'i sigurojë vetëm nga elektorati i Rep.së Shqipërisë. PSSH-ja (Partia Socialiste e Shqipërisë) ka shpallur një program të vetin të quajtur "***Rilindja Kombëtare***". E ka shpallur këtë program dhe, me këtë sllogan, ka organizuar një numër takimesh e diskutimesh. Mirëpo, vihen re, dalin, gjëra që as përafërsisht nuk përputhen me Kombin tonë si tërësi. Diskutohet për ekonominë, por nuk zihen fare në gojë psh. minierat e Trepçës, ndonëse edhe ato janë pjesë e pasurisë sonë kombëtare. Shtrohet platforma e taksavet, por nuk flitet aspak për taksat që arvanitët tanë i paguajnë shtetit grek. Debatohet për

sistemin e drejtësisë, por nuk përmendet gjëkundi EULEKS-i, i cili ka të bëjë drejtpësëdrejti me drejtësinë në Kombin tonë. U mblodh tryezë për mediat dhe nuk u tha asnjë fjalë lidhur me të drejtat e gazetarëvet në Rep.e Kosovës. U mblodh gjithashtu tryezë për sportin, u fol shumë për një deputet dhe për një pistoletë, por nuk u tha asgjë për gjendjen dhe perspektivat e sportit në Ulqin apo në Prevezë. Vetëkuptohet që një e tillë "***Rilindje Kombëtare***", në rastin më optimal, mund të "**rilindë**" vetëm 1/20 (1 të 20-n) e Kombit Shqiptar. Nuk është keq as kaq, në qoftë se arrihet. Por emërtimi, duke qenë drastikisht i pasaktë, është sa qesharak, aq edhe cinik e sarkastik.

III. Përkujdesja Gjithshqiptare nuk mund t'i vihet barrë asnjërit prej konfesionevet tanë FETARË, për arsye se Kombi ynë ka praktikuar dhe praktikon disa religjone. Kryeklerikët shqiptarë, klerikët shqiptarë, si dhe të gjithë besimtarët shqiptarë, të cilitdo besim qofshin, mund dhe duhet të jenë pjesëtarë të Përkujdesjes, pra, mund dhe duhet të jenë patriotë, ashtu siç edhe e kanë dëshmuar në të shkuarën. Ata kanë detyrë madje të punojnë, në emër të Atdheut e të Kombit, që brenda institucionevet të tyre të mos infiltrohen persona, grupe personash, apo edhe ide perfide antishqiptare, siç ka ndodhur e po ndodh me Kishën Ortodokse Autoqefale Shqiptare ose edhe në ndonjë rast tjetër. Përfundimisht, Përkujdesja Gjithshqiptare i ka në gjirin e vet shqiptarët e të gjithë besimeve, por udhëheqja e këtij organizmi panshqiptar nuk mund t'i lihet barrë asnjërit prej përfaqësuesvet të tyre, sepse, po iu la myslimanëvet, të krishterët mbeten jashtë kësaj Përkujdesjeje, e po iu la psh. katolikëvet, myslimanët dhe ortodoksët mbeten përsëri jashtë Përkujdesjes. Rilindësit e kanë pasë zgjidhur më së miri këtë problem tonin jo të vogël.

IV. Përkujdesja Gjithshqiptare kurrsesi nuk mund të jetë USHTARAKE, në radhë të parë, sepse ky Institucion i yni synon t'i zgjidhë problemet që ka Kombi ynë me rrugë të tjera, jo me rrugën e luftës së armatosur. Përkujdesjja Gjithshqiptare nuk mund të jetë usharake, edhe për arsyen se ushtritë u takojnë shtetevet dhe ne e kemi parë që në pikën e parë, që kjo formë e organizimit gjithshqiptar nuk mund të jetë shtetërore. Mirëpo, kjo nuk do të thotë që ushtarakët shqiptarë, kudo që të ndodhen, të mos jenë pjesëtarë të Përkujdesjes. Për forcat e armatosura të 2 shtetevet tanë shqiptarë as që bëhet fjalë, sepse ato e kanë në themel të ekzistencës së vet pikërisht mbrojtjen e Atdheut. Pra, ushtarakët shqiptarë janë vetëvetiu përkujdesës për Kombin tonë. Mirëpo, Përkujdesja Gjithshqiptare ka për synim ta shtrijë influencën atdhedashëse edhe te ushtarakë shqiptarë që gjenden në shërbim të shtetevet joshqiptarë. Ne duhet të arrijmë që asnjë ushtarak me kombësi shqiptare të mos pranojë për të sulmuar Atdheun e Shqiptarëvet, siç ka ndodhur në jo pak raste në të kaluarën. Ç'u tha për ushtrinë, është thënë edhe për policinë.

V. Përkujdesja Gjithshqiptare nuk mund të jetë KRAHINORE, sepse, duke qenë krahinore, ajo do ta prishte unitetin, i cili është më shumë se i domosdoshëm në jetën e një kombi. Përkujdesja Gjithshqiptare vërtet duhet të organizohet në bazë vendbanimesh, por parimi i saj themelor duhet të jetë: Bashkim e jo përçarje. Aty duhet të bëhet kujdes edhe për gjëra që duken të vogla, psh barcoletat e ndryshme. Aty nuk duhet të lejohen dofarë grindjesh apo debatesh të pabukë, që ne shqiptarët i kemi me tepricë: Kush është më trim e kush më pak trim, kush është i ndershëm e kush mashtrues, kush kështu e kush ashtu. Në ambientet ku do të tubohen njerëzit e Përkujdesjes,

duhet punuar me këmbëngulje që, si këngët, ashtu edhe veçantitë e tjera të krahinavet të ndryshme të pëlqehen prej të gjithëvet.

VI. Përkujdesja Gjithshqiptare është NACIONALE, por jo shoviniste. Ajo, jo vetëm nuk e ndjek shembullin e N.Shovenit (N.Chauvin), por është kategorisht kundër një të tillë mentaliteti. Në vend të shovinizmit, nacionalizmi i shqiptarëvet ka tiparet që ia kanë përcaktuar me kohë rilindësit tanë, që në zanafillë të kompaktësimit tonë si komb. Mjafton të lexojmë poemën e N.Frashërit "***Dëshira e vërtetë shqiptarëvet***" (shkruar greqisht). Në këtë mënyrë, nacionalizmi ynë predikon shkuarjen mirë me të gjithë kombet, duke mbrojtur e kultivuar me përkushtim të gjitha veçoritë tona pozitive. Kjo do të thotë: Të shkojmë mirë me kombet e tjerë, por jo t'u biem në gjunjë atyre, sepse nuk ka arsye. Nacionalizmi ynë duhet të kultivojë te pjesëtarët e Kombit tonë krenarinë, madje të ndjerit i lumtur që është i këtij gjaku, i këtij geni, i kësaj race dhe ta dojë e ta propagandojë kudo që të jetë e mundur gjuhën shqipe, një gjuhë me mundësi të jashtzakonshme shprehjeje dhe, së cilës, për nga lashtësia, shumë gjuhë të tjera as që mund t'i afrohen.

MËNYRA E ORGANIZIMIT

Baza e Përkujdesjes Gjithshqiptare është njësia vendore e Përkujdesjes. Aty ka një ambient grumbullimi dhe një person përkujdesës, të cilin unë e kam quajtur PROFESOR. Në të vërtetë, ai duhet të zotërojë, të ketë, tiparet e një MISIONARI të Kombit të vet. Është organizuesi, ligjëruesi, predikuesi, i cili ka për detyrë të mbledhë njerëzit 1 herë në javë, zakonisht të shtunavet, si dhe në ditë të shënuara. Ambienti në lokalin e tubimit u ngjan lokalevet që i kanë shoqatat tona patriotike nëpër botë. (Atje ku shihet e nevojshme, mund ta fillohet puna edhe me 5 njerëz.) Ka në ballë një flamur kombëtar. Ka harta të Shqipërisë dhe të botës, ku tregohen vendndodhjet e shqiptarëvet. Ka fotografi e portrete (vepra

piktorësh) të personalitetevet më të shquar të Kombit tonë. Pamje qytetesh, pamje malesh, pamje lumenjsh, pamje bregdetesh. Natyrisht, ka edhe një bibliotekë me librat më të domosdoshëm që përmbajnë njohuri për Kombin e për Atdheun e shqiptarëvet. Ka doemos edhe një ekran dhe një komplet pajisjesh elektronike dëgjimore-pamore, (audiovizive).

Në ditën dhe orarin e tubimit, orar i cili duhet të jetë i stabilizuar, jo shumë i ndyshueshëm (sepse kjo ka të bëjë me psikologjinë e frekuentuesvet), fillimisht intonohet himni ynë kombëtar. Pas himnit, ligjëruesi, përkujdesësi, mban një ligjëratë që ka lidhje me njohjen e historisë, gjeografisë, gjuhës, folklorit etj. të Shqipërisë e të Shqiptarëvet. Bëhet një interval muzikor me këngë të përzgjedhura mirë. Pjesa e dytë e ligjëratës duhet të bëjë fjalë për problemet aktualë të Kombit tonë dhe për qëndrimin që duhet të mbajnë shqiptarët ndaj njërës apo tjetrës ngjarje. Prapë muzikë, sekuenca filmike etj. Nëse janë mundësitë, mirë është të ketë edhe një ambient sportiv, ku të rinjtë dhe fëmijët të mund të bëjnë ndeshje. Nëse ka mundësi, po në atë vend, bëhen edhe përgatitje grupesh artistikë. Ndërkaq, të rriturit dhe më të moshuarit, bisedojnë, të mbledhur rreth përkujdesësit, për problemet që i ka komuniteti i atyshëm.

Të gjithë ne e dimë që problemet dhe hallet e shqiptarëvet janë aq të shumtë, sa nuk do të mjaftonte 1 ditë në javë për t'i shqyrtuar e për t'u gjetur zgjidhjet. Ambienti, ekonomia, tregtia, punësimi, shkollimi, shëndeti, ndërtimet, dritat, ujësjellësi, veprimtaritë artistike, veprimtaritë sportive, marrëdhëniet me pushtetin, padrejtësitë që u bëhen, sjelljet e njerëzvet, thashethemet, vjedhjet, gjaqet, droga, parandalimi i konfliktevet, brenda familjevet dhe midis familjevet, parandalimi i tragjedivet. Prapë ekonomia, prapë parandalimi i tragjedivet, parandalimi i të atillë mordeve e gjëmave që po ua

mbyllin derën me ferrë qindra familjeve tona, përballja me gjakmarrjet, ngujimet.

Përkujdesësi bisedon me më të mençurit. Shtrohen pyetjet: Çfarë mund të zgjidhim vetë? Çfarë t'u relatohet organevet të pushtetit? Për çfarë të kërkohet ndihmë nga qendra e Përkujdesjes? Për çfarë del e domosdoshme për t'iu drejtuar organevet gjyqësorë? Si të ndihmohet një pjesëtar i yni që ka rënë në burg? Çfarë të bëhet me 1 apo 5 familje që s'kanë bukë të hanë? Ekzistojnë e do të ekzistojnë përjetësisht probleme nga më të ndryshmit, të cilët, po nuk u zgjidhën në mënyrë të organizuar, me metoda të mençura e dashamirëse dhe me drejtësi, u mbeten për t'i "zgjidhur" anarkisë, spontanitetit dhe dhunës.

Cilësitë e MISIONARIT TË KOMBIT SHQIPTAR, që mund të emërtohet modestisht edhe ***përkujdesës***, duhet të jenë TË DALLUESHME. Cilësia e parë e një përkujdesësi të kohës sonë, i cili, mendojmë ne, duhet të jetë udhëheqësi modern i shpirtit tonë kombëtar, është erudicioni i tij. Ai duhet të ketë lexuar dhe të lexojë, në vazhdimësi të pandërprerë, libra të të gjitha sferave, në mënyrë që askush të mos mund ta cilësojë si injorant. Në mënyrë të veçantë duhet të njohë Kombin e vet, në të gjitha fushat: gjuhën shqipe, historinë e ilirëvet, historinë tonë të Mesjetës, kur u quajtëm ***arbër*** dhe historinë tonë të kohëvet më të reja, që kur kemi filluar të quhemi ***shqiptarë***. Duhet të njohë mirë gjeografinë e Shqipërisë, sidomos terminologjinë, e cila është sakatosur më keq se vetë Atdheu ynë. Duhet të njohë historinë dhe gjeografinë e kombevet dhe shtetevet të Ballkanit. Të njohë arkeologjinë e Ballkanit. Të njohë folklorin, vallet e vendit, veshjet, mitologjinë. Si predikues dhe si përhapës i dijevet shqiptare, përkujdesësi duhet të dijë të flasë bukur, të jetë orator. Duhet të dijë të punojë edhe individualisht me

njerëzit, të jetë i afrueshëm. Të dijë të komunikojë me njerëz që kanë nivel të ulët, por edhe me personalitete. Të jetë i guximshëm, por edhe diplomat. Të dijë kur duhet folur e kur duhet heshtur. Të jetë i zgjuar, që të mos bjerë pre e provokacionevet.

Nuk duhet të jetë anëtar i asnjë partie, por kjo nuk do të thotë që ai nuk di ç'janë partitë dhe të mos ketë bindje të caktuara. Është e ditur që çdokush ka bindjet dhe orientimet e vet politikë, ideologjikë, fetarë, por pëkujdesësit tonë kombëtar nuk i lejohet të propagandojë në mënyrë të njëanshme bindjet e veta, sepse ashtu mund të krijojë antipati me njerëzit që kanë bindje të tjera, rrjedhimisht largim njerëzish nga qendra e Përkujdesjes. Nëse ka qenë anëtar i ndonjë partie, ditën kur merr detyrën e përkujdesësit, ai duhet të jetë çantarësuar prej saj. Në këtë mënyrë, në ambientet ku ai punon, nuk duhet të lejohet që dikush të bëjë këmbëngulshëm ndonjë propagandë që sjell përndarje apo përçarje, qoftë partiake, qoftë krahinore apo fetare. Në ambientet e Përkujdesjes Gjithshqiptare duhet të zotërojë vetëm osmoza e shkuarjes mirë me njëri-tjetrin.

Duke qenë se organizimi i Përkujdesjes duhet të bëhet mbi bazën e habitacionit, të vendit ku banojnë njerëzit, e jo të vendit ku punojnë, do të ketë raste kur një pëkujdesës të ketë në juridikcionin e vet psh. kryeministra, ministra, kryetarë partish, kryeklerikë, deputetë, akademikë, ministra, pushtetarë lokalë të të gjithë llojevet. Me të gjithë këta njerëz përkujdesësi, që, në funksionin e vet, është një MISIONAR KOMBËTAR me përgjegësi të mëdha, duhet të jetë i aftë të kontaktojë e të punojë personalisht me secilin prej njerëzve që i përmendëm ma lart. Mbarëvajtja e Kombit varet shumë prej funksinarëvet, kurse sjellja e funksionarëvet varet shumë prej zotësisë së përkujdesësit që merret drejtpësëdrejti me secilin

funksionar. E, kur themi kështu, nuk e kemi fjalën vetëm për politikëbërësit në Tiranë apo në Prishtinë. Aty po se po, por fjala është për secilin shqiptar që ka diçka në dorë, në Ankara, në Stamboll, në Athinë, në Njujork, në Londër, në Podgoricë, në Shkup.

Rrjedhimisht, një veprimtar i yni përkujdesës duhet të ketë kryer, si rregull, një shkollë të lartë. Më të përshtatshmet, si degë, do të ishin ***gjuha shqipe*** dhe ***drejtësia***. Një përkujdesësi që ka diplomuar në degën e ***gjuhës shqipe***, do t'i duhej t'i plotësonte njohuritë e veta edhe në ***jurisprudencë***, kurse një **juristi** do t'i duhej të punonte shumë për të njohur mirë **gjuhën shqipe**. Por kjo nuk do të thotë që funksionin e një përkujdesësi nuk do të mund ta kryente një që ka mbaruar ***shkencat sociale, gazetarinë, inxhinierinë, mjekësinë*** etj. Mjafton që shpirti i tij të rrahë për Kombin e për Atdheun dhe përgjegjësinë e predikuesit të Kombit ta marrë me përkushtimin e duhur, që do të thotë, me përkushtimin e një apostulli.

E kemi thënë që në titull: Askush nuk duhet të mendojë se është punë e lehtë të jesh MISIONAR I KOMBIT tënd, sidomos në këto kohë jashtëzakonisht kritike për fatet e kombevet të vegjël. Për ne, nuk ka qenë e lehtë në kohën e Pushtimit Osman, nuk ka qenë e lehtë nën sllavët e nën grekët e mëparshëm, nuk do të jetë as tash e lehtë.

Po sjellim edhe njëherë në mendje rastin e meshtarit Dom Nikson Shabani në Tivar. U mblodhën 200 **shqiptarë** për të ndaluar priftin që të mos u mësonte fëmijëvet të tyre uratët shqip. Ngrihen **shqiptarët** kundër **shqipes**, sepse kanë frikë të quajturën, jashtë çdo logjike, "***Shqipëri e Madhe***"! Ndërkaq, po në atë Tivar, sërbët ndërtojnë përditë vila e vikendica, rusët ngrejnë hotele nga më atraktivët mu në bregdetin e po atyre shqiptarëve, e nuk kujtohet askush t'i mbledhë ata shqiptarë, që të protestojnë kundër ***Sërbisë***

së Madhe dhe kundër një **Rusie më shumë se të madhe**. A nuk është ky episod, vetëm ky episod, për të mos renditur këtu nja 150, i mjaftueshëm për t'i shqetësuar shumë 2 presidentët e 2 shtetevet tanë?! A nuk mjafton ky episod për t'i shqetësuar shumë, për t'i lënë pa gjumë, kryetarët e partivet politike shqiptare në Mal të Zi?! Dhe, a nuk mjafton ky episod për t'ua bërë shqiptarëvet të domosdoshëm krijimin e INSTITUCIONIT të vet TË PËRKUJDESJES GJITHSHQIPTARE, programin e të cilit do të mund ta përçonin në terren konkret pikërisht dhe vetëm ata që ne po quajmë MISIONARË TË KOMBIT SHQIPTAR?!

Një i tillë MISIONAR duhet të jetë në radhë të parë i mirëpërgatitur për të përballuar format e diskriminimit nga ana e shovinistëvet, të cilët ende, edhe përkundër frazavet demokratike, nuk kanë hequr dorë prej mentalitetevet të tyre tradicionalë. Ato forma diskriminimi janë në gjendje të marrin përmasa të përbindshme. Kështu, një misionar i yni, një profesor i idevet tona kombëtare, ta zëmë, në Anamoravë, do ta ketë shumë më vështirë se sa një deputet shqiptar i po asaj ane. E njëjta situatë, madje edhe më e rëndë, është midis ortodoksëvet shqiptarë, ta zëmë, në Çamëri apo në Konicë, në Follorinë e në Negovan, në vendin ku para 100 vjetësh Papa Kristo Negovani ia pat arritur të ketë 100 nxënës që u mësonte gjuhën shqipe. Shko dhe fol sot me negovanasit! Ashtu si u vra atëherë Papa Kristo Negovani, ashtu do të vritet edhe tash një pasardhës i tiji! Megjithatë, ne jemi të detyruar të çojmë pikërisht atje mësues e predikues të shqipes, po nuk deshëm që mbas 100 vjetësh të tjerë të mos flitet shqip as në Korçë. (Të gjithë e pamë ç'ndodhi me varrezat e Boboshticës dhe me konsullin grek të Korçës.)

Të jesh MISIONAR I KOMBIT nuk është vështirë vetëm jashtë kufijvet të 2 shtetevet tanë, por është tepër vështirë edhe brenda

Rep.së Shqipërisë dhe Rep.së Kosovës. Mjafton të përfytyrojmë vetëm **njërin** prej qindra shembujsh: Ka ardhur PROFESORI, në një lagje qyteti ose në një fshat, emëruar prej Qendrës (Sepse duhet ta dimë që kandidatin mund ta propozojë baza, por emërimin e bën gjithmonë Qendra e Përkujdesjes), i ka mbledhur njerëzit dhe u ka thënë: "***Duam të bëhemi shembull i mirë. Nuk duam pëjetësisht të radhitemi ndër të fundit. Për t'ia arritur këtij qëllimi, na duhet në radhë të parë ne vetë të pastrohemi prej çdo gjëje të keqe. Prandaj***" u thotë ai të pranishmëvet, "***le ta dimë qysh ditën e parë: Çdo lloj korrupsioni do ta denoncojmë, çdo vjedhje do ta denoncojmë, drogën, kultivim, shpërnfdarje, përdorim, do t'i shpallim armiq të komunitetit tonë dhe do t'i denoncojmë, prostitucionin do ta denoncojmë, grindjet, zëniet, mëritë, papastërtitë, të gjithavet do t'u shpallim mospajtimin tonë***." A mund ta përfytyrojmë të lehtë punën e një të tillë përkujdesësi?! Jo. Dhe pikërisht kjo duhet të jetë arsyeja që ne të këmbëngulim për ta krijuar këtë organizëm gjithshqiptar. Ne praktikisht nuk mund të shpresojmë në kurrfarë prosperiteti pa një të këtillë organizëm.

Gjokë Dabaj - Durrës, maj 2012 .

* * *

NJËSITË VENDORE TË PËRKUJDESJES SHQIPTARE

GJOKË DABAJ

Është tepër e rëndësishme, madje jetike për ne, të kuptojmë sa vendimtar është roli i njësivet vendore të atdheekombdashurisë sonë, të patriotizmit tonë.

Kombi, cilido komb, përbëhet prej njerëzish të veçantë, të cilët i bashkojnë disa cilësi të veçanta: gjuhë e veçantë, folklor i veçantë, këngë të veçanta që mund të këndohen vetëm në atë gjuhë, veshje (tradicionale) e veçantë, rite lindjesh, rite dasmash, ceremoni vdekjesh, festa të veçanta, histori e veçantë, vendbanim (i sotëm ose i dikurshëm) i veçantë. Janë, pra, një mori faktorësh që një individ e bëjnë pjesë të një kombi të veçantë.

E gjithë kjo është e krahasueshme (kuptohet, relativisht e krahasueshme), me bimë të ndryshme, me botën e madhe të bimëvet. Fletë të veçanta, degë karakteristike, lule të veçanta, fruta të veçantë, fortësi të veçantë, qëndrueshmeëri ose paqëndrueshmëri ndaj ndryshimevet të klimës, përbëjnë tërësinë e një lloji bime, druri apo peme. Ashtu siç është bota e mbushur me bimë, drurë apo pemë të ndryshme, ashtu është bota e mbushur edhe me kombe të ndryshëm. Madhështia e botës bimore qëndron te larmia e bimëvet, te numri i shumtë i llojevet bimorë. Madhështia e botës njerëzore qëndron te larmia e kombevet, e gjuhëvet, e kulturavet, e traditavet, e së kaluarës, e vendevet ku janë stisur. Nëse në botë do të ekzistonte vetëm 1 lloj bime, kjo nuk do të kish kurrfarë kuptimi. Pamja e përgjithshme do të ish monotone dhe nuk dihet nëse do të mund të vazhdohej gjatë vetëm me 1 bimë. Nëse në botë do të ekzistonte vetëm 1 komb, kjo gjithashtu nuk do të kish kurrfarë kuptimi. Jeta njerëzore mbi tokë do të bëhej monotone, vetëmbytëse.

Sidoqoftë, duhet ditur mirë, duhet kuptuar mirë, që ekzistenca e pyjevet me lisa varet prej mënyrës si funksionojnë fletët, degët, rrënjët e secilit lis të veçantë. Kështu duhet kuptuar edhe veprimtaria vendore, lokale, e njësivet të secilit komb, e, në rastin tonë, e Kombit tonë, e lisnajës sonë. Sa më vitalë të jenë lisat e veçantë, aq më madhështore do të jenë lisnajat.

Mu për këtë arsye e kemi të domosdoshme që ne shqiptarët të krijojmë një model veprimtarie të njësive VENDORE, kudo që jetojnë shqiptarët. Thënë prapë me gjuhën e botanikës, jo të lihen bimët tona në gjendje të egër, të cilat të mund t'i shkulë, t'i presë e t'i djegë

kush të dojë, por t'i nënshtrohen ato një kultivimi të vetëdijshëm e shkencor, në mënyrë që të mund t'u mbijetojnë edhe stinëvet të thata, edhe furtunavet.

Një të këtillë veprimtari lokale, vendore, mund ta quajmë, pra, PËRKUJDESJA VENDORE E SHQIPTARËVET. Në të gjithë Kombin tonë ka atdhetarë e njerëz të vetëdijshëm se, pa i ruajtur veçoritë kombëtare, as veçoritë apo zotësitë vetjake, personale, nuk mund ta arrijnë vlerën e vet të mirëfilltë. Që këta shqiptarë të mund të përkrahin e ndihmojnë njëri-tjetrin dhe të zgjërojnë rrethin e vet, duhet që TË MBLIDHEN **FIZIKISHT** rreth njëri-tjetrit. Modeli më i mirë i një veprimtarie të këtillë, është ky: gjendet, (me mjetet vetjakë), një ambient, një dhomë, një shtëpi, një sallë apo një ndërtesë më vete, ku shqiptarët e një vendbanimi të mblidhen CEREMONIALISHT njëherë në javë. Nuk është e rekomandueshme, as e përshtatshme, as e hijshme, që njerëzit të mblidhen CEREMONIALISHT çdo ditë e çdo natë, por nuk është e rekomandueshme as të mblidhen më rrallë se njëherë në javë. Ora duhet të jetë rigorozisht e përcaktuar. Psh, dimrit, ora 17, verës, ora 21. Ose ndonjë orar tjetër, por gjithmonë i detyrrueshëm për t'u respektuar. Drejtues i veprimtarisë duhet të jetë një njeri i ditur, por edhe i apasionuar pas çështjes kombëtare. Pjesëmarja nund të fillojë EDHE me 5 vetë, me synimin dhe shpresën që ai numër të vijë gjtihnjë duke u rritur.

Veprimtaria fillon me Himnin tonë Kombëtar, i cili ekzekutohet me mjete audiovizivë elektronikë dhe shoqërohet solemnisht nga të gjithë të pranishmit, duke qëndruar më këmbë. Flamuri ynë Kombëtar qëndron në krahun e djathtë të katedrës, ku gjendet përkujdesësi, predikuesi, profesori. Në ata shtete të huaj, ku me ligj është i detyrueshëm edhe flamuri i atij shteti, natyrisht, në shenjë

luajaliteti, vendoset edhe flamuri i atij shteti. Por vetëm kur detyrohet me ligj, jo vullnetarisht.

Mbas Himnit, profesori mban një ligjëratë me përmbajtje kombëtare: Kapitull mbi probleme të gjuhës shqipe, kapitull nga historia e shqiptarëvet, kapitull nga gjeografia e Shqipërisë, nga arkeologjia, nga folklori, nga etnokultura, nga jeta e personalitetevet tanë kombëtarë, nga letërsia. Sigurisht, me ilustrimet e nevojshëm dhe shoqëruar me mjetet modernë ose jomodernë të paraqitjes pamore. Jo më shumë se 30 minuta.

Vazhdon një intermexo 10-minutëshe me këngë apo melodi të zgjedhura kombëtare, popullore ose me autorë të njohur, herë nga një krahinë e herë nga një krahinë tjetër e vendit tonë, ose që lidhet me personalitetin apo krahinën, për të cilët është folur atë ditë.

Mbas intermexos, profesori paraqet gjendjen aktuale, ngjarjet që kanë ndodhur gjatë javës e që lidhen me Kombin Shqiptar dhe me hapësirat gjeografike të Shqipërisë. Jepen edhe udhëzime, si duhet t'i kuptojmë dhe si duhet të reagojmë ndaj atyre ngjarjeve. E gjithë kjo, jo më shumë se 20 minuta.

Mbaron parashtrimi. Mbyllet me një këngë mobilizuese, entuziaste, ose edhe solemne të dhimbshme, sipas rastit.

Rinia shpërndahet dhe mund të merret me sport apo me veprimtari të tjera kulturore artistike, me internet, me lexime, por, atë natë, gjithsesi me përmbajtje patriotike.

Më të moçmit, mundet edhe dikush prej të rinjvet, mblidhen në një dhomë më vete dhe trajtojnë problemet që ka komuniteti shqiptar në vendin ku ai komunitet jeton: Punësimi, shkollimi, ndriçimi, ushqimi, uji, pastërtia, gjaqet, gjyqet, korrupsioni, padrejtësitë,

droga, prostitucioni, marrëdhëniet me fqinjët joshqiptarë, arti, libri, sporti, reklamat, shtypi, propaganda. Qindra probleme kanë komunitetet, dmth njerëzit të cilët banojnë në një vend të caktuar. Diskutohen këta probleme dhe caktohen rrugët e daljes nga gjendja, rrugët më optimale të zgjidhjes. Në të gjithë rastet evitohet, shmanget çdo lloj grindjeje apo mërie. Lihen afatet. Javën tjetër shikohet çfarë është bërë.

Organi i përkujdesjes vendore nuk është organ pushteti, as organ partie. Ai është një ORGANIZËM NDËRGJEGJJOR E SHPIRTËROR KOMBËTAR. Kur themi ***ndërgjegjjor***, kjo do të thotë se ka të bëjë me mendjen, me mënyrën e të menduarit të banorëvet përkatës. Kur themi ***ndërgjegjjor***, kjo do të thotë që njerëzit e atij komuniteti, me anë të vetëdijes së vet, me anë të mendjes së vet, këtë herë të përbashkuar, kërkojnë dhe gjejnë mënyra për të zgjidhur problemet që kanë dhe që në shumë raste nuk janë aspak të lehtë. Kur themi shpirtëror, kjo do të thotë që komunitetin përkatës e përafrojnë, e lidhin fije të shumta të prejardhjes, gjuhës së të parëvet, këngëvet, historisë, madje edhe të gjakut, sepse çdo shqiptar, sado e çuditshme të duket, ka gene të përbashkët me çdo shqiptar tjetër. Kjo nuk do të thotë që ai s'mund të ketë përzierje me kombe të tjerë, por prej kombit të vet doemos e ka pjesën kryesore të qenies së vet. Lidhjet shpirtërore midis pjesëtarëvet të një kombi janë të pazëvendësueshme. Veçse ato duhet të kultivohen. Organi i përkujdesjes vendore muk është organ pushteti partie, por, megjithatë, ai ka lidhje me organet e pushtetit dhe të partivet. Ka lidhje, sepse, nëpërmjet përfaqësuesvet të vet, ai u drejtohet atyre organeve, sidomos organevet të pushteit, për të zgjidhur problemet.

Kur flasim për krijimin e njësive vendore të përkujdesjes shqiptare, është shumë e rëndësishme të kuptohet që askush nuk duhet të

presë që të këtilla njësi të krijohen me urdhëra nga ndonjë organ epror apo madhor. Këto njësi krijohen kudo ku ndihet nevoja dhe ku ka vullnet për t'i krijuar. Kudo ku ka shqiptarë, të cilët e shohin të nevojshme të lidhen njëri me tjetrin dhe t'ia lehtësojnë njëri-tjetrit vështirësitë dhe hallet e jetës. I krijojnë njerëzit vetë. S'ka nevojë t'u japë dikush urdhër. Mjafton ta zbatojnë skemën që dhamë më sipër, sepse ajo ka shumë rëndësi.

Kur të kemi një organ qendror të Përkujdesjes Gjithshqiptare, atëherë do të bashkohen të gjitha këto njësi vendore dhe çdo gjë do të shkojë më mirë e më lehtë. Do të shkojë më mirë e më lehtë, sepse koordinimi i veprimevet do të jetë më i përbashkuar, problemet financiarë do të zgjidhen më mirë, ndikimi ynë në organet ekonomikë, shtetërorë e politikë, në dobi të Kombit tonë, do të bëhet përherë e më i fuqishëm. Duhet theksuar: Jo ndikimi i partivet apo i pushtetit mbi ne, por ndikimi ynë mbi ta.

Vetëm kur të kemi arritur të kemi një organ qendror të Përkujdesjes Gjithshqiptare, dmth kur të kemi arritur t'i bashkojmë njësitë vendore që i përmendëm më lart, nën një udhëheqje të vetme, do të mund të themi që i kemi hyrë realisht rrugës së përparimit. Do të bashkohen ashtu njësitë vendore ekzistuese dhe do të punohet që krejt Kombi ynë, i pajisur me një vetëdije e kulturë moderne, të përfshihet në morinë e të këtilla njësive vendore. Filluar nga Tirana a Prishtina e deri në Stamboll. Athinë, Boston apo Londër, Kombit tonë do t'i duhen diku rreth 150 mijë a 200 mijë njësi të tilla vendore të përkujdesjes. Dhe atëherë nuk do të mund më të luhet asnjë lojë mbi kurrizin tonë.

Gjokë Dabaj - Durrës, 12 qershor 2012.

* * *

GJOKË DABAJ

FJALËMIRA E GJUHËS SHQIPE

Në librin tim (me pretendim manifesti), "***Strategjia e shqiptarëvet***", në kapitullin "***Shqipëria si duhet të jetë?***", e kam potencuar, e kam theksuar me forcë, se shqiptarët e kanë **TË DOMOSDOSHME** të krijojnë një INSTITUCION të vetin KOMBËTAR. Arsyetimet, gjatë gjithë atij libri, janë dhënë të atillë që lexuesit duhet t'i mbushet mendja se Kombit tonë vërtet i duhet një i tillë INSTITUCION (SHPËTIMTAR), përndryshe, ai mbetet përsëri o i rrëzikuar për t'u zhdukur ose i rrëzikuar për t'u katandisur në një komunitet mjeranësh, fatin e të cilit e vendosin gjithmonë të tjerët. Në 2-3 artikuj të mëvonshëm, në portalin tonë prestigjoz kombëtar "***Pashtriku***", ndoshta të vetmin të tillë në publicistikën shqiptare të sotme, janë bërë edhe disa sqarime, në mënyrë që platforma e parashtruar të mund të kuptohet sa më mirë.

Po jap tani, në vazhdim, sqarime të mëtejshëm.

Për të krijuar INSTITUCIONIN në fjalë, të emërtuar ***PËRKUJDESJA GJITHSHQIPTARE***, duhet të ketë, sa për fillim, si në të gjithë rastet, kur njerëzit bëjnë organizime, një **grup nismëtar**. Ai **grup nismëtar** do të hartonte një program, më konkret e më të detajuar, të krijonte e të siguronte dokumentacionin e nevojshëm për t'u regjistruar si OJQ (organizatë joqeveritare) apo disi ndryshe, të regjistrohej si e tillë dhe të krijonte **Këshillin e Përkohshëm Drejtues.**

Përfytyrimi im i një të tillë **KËSHILLI DREJTUES TË PËRKUJDESJES GJITHSHQIPTARE**, fillimisht të përkohshëm, pastaj të përhershëm, është ky:

1. **Kryetari**, me seli e banim në Prizren.

2. **Nënkryetari**, i ngarkuar për punë me personalitetet e Kombit tonë. (Nuk ka rëndësi vendi i banimit, mjafton të jetë personi i duhur.)

3. **Anëtar**, i ngarkuar për punë me mërgimtarët tanë të hershëm, arbëreshët e Italisë, arvanitët e Greqisë, arbëneshët e Dalmacisë dhe kudo ku ka koloni të hershme ose emigrantë prej atyre kolonive, të shpërndarë nëpër botë.

4. **Anëtar**, i cili do të kujdeset për mërgimtarët tanë të 2 shekujvet të fundit, filluar nga Turqia e Greqia deri në Kanada, SHBA e Zelandë të Re.

5. **Anëtar**, që do të kujdeset për shqiptarët që janë autoktonë: në Rep. e Greqisë, në Rep. e Sërbisë, në Rep. e Malit të Zi.

6. **Anëtar**, i cili do të kujdeset për shqiptarët në Rep. Ish-Jug. të Maqedonisë.

7. **Anëtar**, i cili të kujdeset për shqiptarët në Rep. e Kosovës.

8. **Anëtar**, i cili të kujdeset pë shqiptarët në Rep. e Shqipërisë.

9. **Anëtar**, që do të kujdeset për marrëdhëniet ndërfetare dhe për marrëdhëniet midis shqiptarëvet me orientime të ndryshëm ideologjikë e politikë.

Kam menduar që përbërja prej 9 vetësh e këtij Këshilli të ndjekë trashëgimisht rrugën e Komitetit të Stambollit, themeluar në Stamboll në dhjetor 1877, prej një grupi rilindësish tanë më të përkushtuar. Prizrenin e kam menduar si seli të përhershme të këti INSTITUCIONI, midis tjerash, edhe sepse aty është realizuar i pari bashkim i mirëfilltë kombëtar në historinë tonë të re. (Ne duhet të mbetetmi trashëgues të përkushtuar pikërisht të atij bashkimi, ndryshe, vazhdon procesi i copëtimit! Ndryshe, copëtimi nuk ka të pushuar!) Mbështetur në të arriturat e sotme teknike e teknologjike, sidomos të informatikës, kam menduar që, përveç KRYETARIT TË PËRKUJDESJES, me personelin përkatës administrativ, i cili, me kalimin e kohës, do të vijë duke u rritur, asnjëri prej ANËTARËVET

TË KËSHILLIT TË PËRKUJDESJES, nuk do të jetë i detyruar të jetojë në Prizren. Që të 8 anëtarët e tjerë, pra, mund të jetojnë atje ku kanë punën dhe familjen. Mjafton që ata ta ushtrojnë ashtu si duhet funksionin e tyre dhe, 1 herë në javë t'i çojnë informacion KRYETARIT. Kështu, KËSHILLI, si rregull, do të duhet të mblidhet 1 herë në çdo 6 muaj, e, vetëm në raste të ngutshëm, edhe më shpesh.
Nuk po zgjatem më për të përshkruar punën e KËSHILLIT TË PËRKUJDESJES GJITHSHQIPTARE. Puna e tij do të ishte (do të jetë, nëse krijohet), aq e gjithanshme dhe aq voluminoze, sa do të duhet një libër qindra faqesh për të paraqitur vetëm programin.
Dua të them vetëm edhe këtë: Ky INSTITUCION i yni KOMBËTAR nuk parashikohet të jetë i përkohshëm. Ky INSTITUCION nuk do të shikojë kurrë sa shqiptarë ka përfshirë nën PËRKUJDESJE, por gjithmonë: Edhe sa shqiptarë i kanë mbetur jashtë PËRKUJDESJES. Jeta e këtij INSTITUCIONI nuk përcaktohet as me dhjetëvjeçarë, as me qindvjeçarë. Prandaj, njerëzit që do t'i hyjnë punës për ta themeluar dhe drejtuar këtë INSTITUCION tonin, duhet të jenë idealistë të mëdhenj dhe jo më të moçëm se 40 vjeç. Unë jam 75 vjeç. Unë nuk bëj për këtë punë. Unë, këtu, mund të hyj në punë, edhe pak ditë, vetëm si një këshillues. Sami Frashëri ka qenë vetëm 25 vjeç, kur është zgjedhur Kryetar i Komitetit të Stambollit. O Zot! Çfarë madhështie! Vdiq 54 vjeç, por mbeti i përjetshëm!
Puna e parë, fill mbas konsolidimit si KËSHILL NISMËTAR I PËRKUJDESJES GJITHSHQIPTARE, është krijimi i një NJËSIE VENDORE të kësaj PËRKUJDESJEJE. Eksperimentale e, madje, mu në Prizrern.
Krejt trupi, krejt organizmi i kësaj PËRKUJDESJEJE do të përbëhet prej një numri tash për tash të papërcaktueshëm NJËSISH VENDORE. Roli i atyre NJËSIVE VENDORE do të jetë VENDIMTAR në krejt ecjen ose jo të Kombit tonë në rrugën e prosperitetit. Ato NJËSI

VENDORE duhet dhe do të jenë, nëse subjektet e vetëthirrur prej kësaj ideje, do ta kuptojnë seriozisht këtë punë, QELIZAT e PËRKUJDESJES sonë GJITHKOMBËTARE. Ato do të mund të krahasoheshin, sigurisht, në aspektin kombëtar e kurrsesi në aspektin religjioz, me tempujt e budistëvet, me sinagogat, me kishat, me xhamitë me teqetë.

Një të tillë NJËSI VENDORE të PËRKUJDESJES GJITHSHQIPTARE unë e kam quajtur ***FJALËMIRA E GJUHËS SHQIPE***. Emërtim më i bukur e më i përshtatshëm nuk mund të gjendet mbi këtë Dhe.

Më poshtë po paraqes pamjen dhe funksionimin, në formë konspekti, të një të tillë **FJALËMIRE**.

Një sallë, në të cilën mund të hyjnë e të rrinë ulur, 100 deri 120 vetë. Në krye të sallës, një katedër, me arkitekturën përkatëse në funksion të qëllimit, me **Flamurin Kombëtar Shqiptar** në njërin krah, dhe, atje ku kjo kërkohet me ligj, edhe me flamurin shtetëror në krahun tjetër. Në sipërfaqet prapa katedrës, prapë në funksion të qëllimit, një ekran i madh dhe harta e piktura, të përhershme ose të përkohshme. Anash: Pamje nga Atdheu ynë, piktura, portrete, skulptura, bazoreliefe, lule. Të gjitha me estetikë sa më mbresëlënëse dhe me përmbajtje kombëtare. Kuptohet, këtu hyjnë edhe autorë shqiptarë, veprat e të cilëvet mund të mos kenë subjekt shqiptar, por që autori është i yni, shqiptar. Gjithkështu anash, deri në lartësinë nën 2 metra, rafte me libra. E gjithë salla, e pajisur me instalime audiovizivë. Në krah të katedrës, një dixhei, kompjuter, internet dhe aparate incizimesh.

Krejt punën e FJALËMIRËS SË GJUHËS SHQIPE e udhëheq një nëpunës i PËRKUJDESJES, i paguar sipas rregullavet, me diplomë universiteti, mundësisht të ketë mbaruar për gjuhën shqipe. Unë e kam quajtur këtë lloj funksionari, që është shumë i rëndësishëm, me një emër të përgjithshëm PROFESOR, dhe mendoj që kështu duhet ta

thërrasin të gjithë frekuentuesit e FJALËMIRËS. Ai, natyrishish, vishet si të gjithë profesorët: Me kostum qytetar, me ose pa kravatë etj, sipas vendit dhe sipas stinës. Por, në krahë të tij, është e udhës që rrinë më këmbë 2 fëmijë 10-15 vjeç, 1 vajzë e 1 djalë, veshur me kostume tradicionalë të krahinës ose me ndonjë kostum tipik shqiptar nga më të pëlqyeshmit. Po kështu, edhe në të 2 krahët e hyrjes në sallë, duhen 2 djem 18 vjeç e lart, veshur edhe ata me kostumet tradicionalë të krahinës apo me ndonjë tjetër kostum tipik shqiptar nga më të pëlqyeshmit. Këta djem i duhen FJALËMIRËS, për të mirëpritur frekuentuesit, për t'u ofruar atyre vendet ku do të ulen dhe, sigurisht, edhe për të ruajtur apo vendosur qetësinë.

Detyra kryesore e FJALËMIRËS SË GJUHËS SHQIPE është që t'i mbledhë në atë sallë shqiptarët e atij komuniteti e pakta 1 herë në javë, në një ditë rigorozisht të përcaktuar. Psh çdo të shtunë mbasdite, në orën që të gjykohet si më e përshtatshmja.

Në të tillë tubime të rregullt, nën udhëheqjen e PROFESORIT, organizohet një ceremoni, ecurinë e së cilës unë e kam përfytyruar kështu: Pasi njerëzit janë ulur në vendet e tyre, në minuten që është caktuar për fillim, PROFESORI, që nga katedra, bën përshëndetjen mirseardhëse dhe ndonjë lajmërim fare të shkurtër, dhe u lutet pjesëmarrësvet që të çohen në këmbë për të nderuar intonimin e **Himnit Kombëtar Shqiptar**.

Ulen pjesëmarrësit, PROFESORI mban një ligjëratë që lidhet me Kombin Shqiptar, jo më shumë se 20 minuta. Temat e ligjëratavet janë nga më të ndryshmet. Për gjuhën shqipe (gjithmonë diçka konkrete, pa teorizime), për historinë e shqiptarëvet (prapë me përzgjedhje konkrete), për gjeografinë, për ekonominë, për natyrën shqiptare, për arkeologjinë, për folklorin, për letërsinë, për sportin, për pikturën, për kinematografinë, për muzikën, për veshjet, për dasmat, për llojet e gatimevet që i praktikojnë më së shumti

shqiptarët, për vallet dhe valltarët. Gjithmonë, 1 ose 2 nga këto tema. Jo grumbull, e të mos mbahet mend asgjë.
Mbasi mbaron ligjërata e parë, në dixhei lëshohet muzikë e zgjedhur kombëtare. Natyrisht, jo përherë vetëm popullore. Muzikë kombëtare, e zgjedhur mirë, frymëzuese dhe që nuk përsëritet, për t'u bërë bajate.
Këtu ka 10 minuta kohë, ose ndoshta diç më shumë, në të cilën 2 fëmijët dalin midis pjesëmarrësvet dhe mbledhin kontributin financiar, i cili është tepër i nevojshëm për funksionimin, si të asaj FJALËMIRE, ashtu edhe të krejt INSTITUCIONIT TË PËRKUJDESJES. Secili nga 2 fëmijët mban në duar nga një kasë, të themi, speciale. Themi speciale, sepse ajo kasë duhet të mos lërë shteg për abuzime. Ose të paktën të mund t'i minimizojë abuzimet. Ka nga mbrapa 5 drynj, mbasi KËSHILLI i çdo FJALËMIRE përbëhet prej 5 vetësh. Anëtarët e KËSHILLIT të FJALËMIRËS kanë secili nga një dry dhe çelësin e mbajnë me vete. Kasa ka sipër një të çarë, ku lëshohen të hollat, aq sa mundet dhe aq sa dëshiron me dhanë secili. Por duhet mbajtur parasysh që ky kontribut nuk mund të quhet asnjëherë **ndihmë**. Ky kontribut është **detyrim kombëtar**, më i shenjti prej të gjithë "kontributevet" që japin shqiptarët në të katër anët, qysh prej bakshishevet korruptues e dhuratavet nëpër dasma e deri te taksat e tatimet shtetërorë 20 llojesh. Fëmijët mbajnë me vete edhe nga një tufë zarfash të vegjël, në mënyrë që ndonjë kontribues të mund t'i shtjerë në zarf të hollat, duke iu shënuar sipër zarfit emri dhe sasia e të hollavet. Të gjithë ata që japin sasi më të madhe të hollash, të shtunën që vjen, komunikohen dhe falenderohen para pjesëmarrësvet. Mbasi mbaron ceremonia, në fund fare, të 5 anëtarët e KËSHILLIT TË FJALËMIRËS mblidhen, e hapin kasën, i numërojnë të hollat, bëjnë distinën, firmosin dhe PROFESORI është i detyruar menjëherë t'ia dërgojë Qendrës në Prizren, bashkë me

distinën. Gjysma e kontributevet, normalisht, i takon asaj FJALËMIRE, por kalimi i shumavet bëhet gjithmonë nga Qendra, me destinacion të përcaktuar qartë.

Ligjërata e dytë, mbas pushimit 10-minutësh, gjatë të cilit janë mbledhur edhe kontributet, zgjat gjithashtu 20 minuta. PROFESORI, në këtë pjesë të ceremonisë, u flet pjesëmarrësvet lidhur me ndonjë ngjarje aktuale. Këto ligjërata zakonisht përgatiten në Qendër, por mund të kenë të bëjnë edhe me ngjarje lokale. Ky 20-minutësh është caktuar për t'i mbajtur pjesëmarrësit, dmth shqiptarët e atashuar pranë FJALËMIRAVET TË GJUHËS SHQIPE, në korrent të ngjarjevet që lidhen me fatin e Kombit tonë, rrjedhimisht, me fatin e secilit prej nesh, dhe prandaj për të mbajtur qëndrim ndaj atyre ngjarjeve.

Mbasi mbaron edhe kjo pjesë e ligjëratës së PROFESORIT, ai bën komunikimet e fundit, ndonjë lajmërim, ndonjë kërkesë etj dhe, nën melodinë e këngës "***Për ty, Atdhe***", pjesëmarrësit shpërndahen. Në ambientet e jashtëm, atje ku ekzistojnë mundësitë, zhvillohen lojëra sportive.

Pjesa e tretë e ritualit u kushtohet problemevet që ka komuniteti shqiptar në vendin ku vepron secila FJALËMIRË. Të 4 anëtarët e KËSHILLIT, bashkë me PROFESORIN, presin njerëzit që kanë halle, i dëgjojnë, mbajnë shënime, bisedojnë mbi rrugët dhe mundësitë se si mund të zgjidhet secili rast. Gama e problemevet që mund të ketë një komunitet, është shumë e gjërë dhe pafundësisht e larmishme: Probleme me administratat, probleme me organet e tjerë të shtetit, me gjykatat, me policitë, probleme dokumentesh, probleme ekonomikë, probleme të punësimit, probleme banimi, probleme shkollimi, marrëdhënie midis fqinjëvet, marrëdhënie në familje, sherre të ndryshëm, gjaqe, probleme droge, pije, dehje me alkol, prostitucion, probleme të burgosurish, të cilët shpeshherë duhet të mbrohen, probleme korrupsioni, probleme infrastrukture, drita,

ujë, rrugë, telefona, probleme sëmundjesh, probleme tatimesh e taksash, probleme higjene.

Gjatë gjithë javës, PROFESORI merret me zgjidhjen ligjore ose thjeshtë ndërnjerëzore të të gjithë problemevet që i janë parashtruar. Të shtunën tjetër ai i njofton të interesuarit për çfarë ka mundur të bëjë dhe për çfarë nuk ka mundur.

E thashë që gama e këtyre problemeve është shumë e gjërë dhe vetëm rreshtimi i disave prej tyre e bën të qartë, sa të domosdoshme e kanë njerëzit tanë, kudo që ndodhen, për të pasur një INSTITUCION TË PËRKUJDESJES dhe, në kuadrin e atij INSTITUCIONI, për të pasur, në vendin ku ata jetojnë, një qelizë të atij INSTITUCIONI që unë e kam quajtur ***FJALËMIRA E GJUHËS SHQIPE***.

Në përfytyrimin tim, në vizionin tim, një i këtillë organizëm u duhet shqiptarëvet më shumë se çdo gjë tjetër. Unë nuk e shoh PËRKUJDESJEN GJITHSHQIPTARE si një luks, si një komoditet, si diçka që "është mirë ta kemi". Unë e shoh krijimin dhe funksionimin e PËRKUJDESJES GJITHSHQIPTARE dhe të FJALËMIRAVET TË GJUHËS SHQIPE, kudo ku ka shqiptarë dhe në numër sa më të madh, si një **DOMOSDOSHMËRI JETIKE TË KOMBIT TONË**.

Gjokë Dabaj - Durrës, 21 tetor 2012.

* * *

ARKITEKTURA E NJË FJALËMIRE TË GJUHËS SHQIPE

GJOKË DABAJ

Që të mund të vihet në jetë dhe të ketë jetë të gjatë ideja që po e marrim në shqyrtim, ajo duhet të ketë të paktën 3 përbërës të qëndrueshëm:

1. një literaturë të shkruar,

2. një organ qendror drejtues dhe

3. një numër zbatuesish vendorë të literaturës përkatëse, si dhe të direktivavet të qendrës.

Që të 3 këta përbërës janë të domosdoshëm dhe pa ekzistencën dhe funksionimin e tyre, vetë ideja mbetet e pazbatueshme. Por unë do të ndalem tash vetëm te pika e tretë.

Duhet thënë që në fillim që, krejt ky projekt i imi, nuk është shpikje, por është një kopjim, ose më saktë, një kompilim i përvojavet mijëvjeçare gjithnjerëzore. Të gjithë religjionet e derisotëm, kanë

jetuar gjatë, falë pikërisht komponentit të tretë, predikimit në terren. Paganizmi ka pasur faltoret dhe tempujt e vet, hebraizmi, sinagogat dhe rabinët, krishtërimi, kishat dhe priftërinjtë, islamizmi, xhamitë dhe hioxhët.

Njësitë vendore të projektit tim, të quajtur Përkujdesja Gjithshqiptare, unë i kam emërtuar Fjalëmira të Gjuhës Shqipe.

Që një njësi vendore të jetë funksionale, asaj i duhet pa tjetër një vend tubimi, një predikues dhe një rit sa më i përshtatshëm, për t'i shërbyer qëllimit.

Kthehemi prapë te religjionet, ndonëse kjo që po predikoj unë, nuk është mirëfilli religjion, por, në shumë pika i afrueshëm. Që predikimi i hebraizmit të jetë funksional në qëllimin e vet, njësia e tij vendore duhet të ketë një sinagogë, një rabin dhe një rit të konsoliduar brenda asaj sinagoge.

Thelbi i idesë që predikoj unë, është përjetësimi dhe zhvillimi i mëkëndejshëm i idevet të Rilindjes sonë Kombëtare, duke e kompletuar INSTITUCIONIN që rilindësit e zunë fill, me elementët e domosdoshëm të jetëzgjatjes.

Po jap këtu të skicuar pamjen fizike të një Fjalëmire. (Shih figurën) Pamja ballore e ndërtesës fjalëmirore tregon që ajo ka 3 të ndara kryesore. Në qendër është salla e predikimevet dhe e ceremonivet, Prushi i Fjalës, në njërin krah janë ambientet ku përvetësohen dijet, Prushi i Dijes, ndërsa në krahun tjetër është ambienti që unë e kam quajtur Prushi i Përjetësisë.

Po i përshkruaj këta ambiente dhe funksionet e tyre një për një dhe fare shkurt.

1. Predikatorja, ajo që unë e kam emërtuar Prushi i Fjalës, është një sallë, në të ciën mund të ulen deri 100 vetë. (Pa dallim feje apo prejardhjeje krahinore, ashtu siç është krijuar tashmë në kombin tonë një traditë që pakkush mund ta ketë) Ka një katedër, prej nga predikon profesori, predikuesi i Fjalëmirës. Në sfond, prapa predikuesit, ka 2 flamuj, flamuri ynë kombëtar dhe, për luajalitet, flamuri i shtetit ku gjendet Fjalëmira. Përballë, anash dhe gjithandej, ka zbukurime figurative: fotografi, piktura, bazoreliefë, skulptura, harta, që të gjitha me përmbajtje iliro-arbro-shqiptare. Salla është e pajisur me mjetet e kohës audiovizivë elektronikë. Ka, në krah të predikuesit një dixhei, të cilin e vë në punë njëri nga ndihmësit e predikuesit të Fjalëmirës. Veç dixheistit, në krahët e predikuesit qëndrojnë 2 fëmijë, veshur me rroba krahinore kombëtare. Te dera e sallës qëndrojnë edhe 2 djem 20-30-vjeçarë, veshur edhe ata me rroba kombëtare, sigurisht të stilizuara. Funksioni i tyre është, të mirëpresin pjesëmarrësit dhe të mbajnë rend e rregull në sallë.

Ceremonia, zakonisht, është javore, komuniteti mblidhet aty si rregull 1 herë në javë, por mund të praktikohet edhe në raste të veçantë: Festa e përvjetorë, vizita personalitetesh, ligjërata njerëzish të shquar, koncerte këngëtarësh.

Riti, sipas idesë sime, është ky: Predikuesi (profesori) zë vend prapa katedrës. Çohen në këmbë pjesëmarrësit, ekzekutohet Himni ynë Kombëtar, ulen pjesëmarrësit, predikuesi mban një ligjëratë 20-minutëshe me temë nga historia, gjuha, folklori, letërsia, arkeologjia, monumentet tanë të cultures, martirët e Kombit shqiptar, etnografia. Bëhet një pushim 10-minutësh, 2 fëmijët, secili me nja një kuti në dorë, kuti e posaçme, të cilën nuk po e përshkruaj tani, mbledhin kontributin në monedha, që pjesëmarrësit e japin për të siguruar mbarëvajtjen e INSTITUCIONIT. Në 20 minutat pauses

predikuesi trajton një temë aktuale. Informon pjesëmarrësit mbi ngjarjet kryesore që lidhen me Kombin Shqiptar dhe, me atë rast, përcaktohet qëndrimi që duhet mbajtur, si dhe mund të propzohet ndeonjë veprim konkret në funksion të njërës apo tjetrës ngjarje. As ky ligjërim nuk duhet të zgjatë më shumë se 20 minuta. Në mbyllje intonohet një këngë patriotike, psh "Për ty, atdhe!" ose ndonjë tjetër, por gjithmonë me masën e duhur, pa I bajatur gjërat.

Në pjesën e tretë, pasi të jenë shpërndarë pjesëmarrësit, predikuesi bashkë me 4 anëtarë të Këshillit të Fjalëmirës, dëgjojnë prej banorëvet të komunitetit përkatës, problemet konkretë që ata i shqetësojnë, ankesat, hallet, propozimet. Mbahen shënimet për çdo çështje, kërkohen rrugëzgjidhje, merren mendimet e këshilltarëvet dhe, gjatë javës predikuesi duhet të përpiqet për t'i zgjidhur problemet që janë shtruar. Javën tjetër ai raporton mbi punët e kryera. Nuk do harruar që të gjithë komunitetet, në këtë rast shqiptarët, kudo që ata ndodhen, kanë me dhjetëra e me qindra problem të jetës së tyre të përditshme. Vetëm për këto punë do t'ia vlente të krijohej Fjalëmira e Gjuhës Shqipe.

2. Ambientet ku përvetësohen dijet, që unë i kam emërtuar Prushi i Dijes, vendosur në njërin krah të predikatores, përbëhen prej e pakta 4 të ndarash. Një bibliotekë me libra shqip, një arkiv sa më të plotë dhe sa më funksional për komunitetin, një klasë për mësimin e gjuhës shqipe (Aty ku ka shkollim shqip, ky kabinet shërben për gjuhë të huaja.) dhe një klasë për mësimin e gjuhës apo gjuhëvet që flasin bashkëbanorët: Në tivar gjuha malazeze, në shkup gjuha sllavomaqedone, në Gjenevë gjuha frënge, në Këln gjuha gjermane, në Izmir gjuha turke.

Për funksionimin dhe punët e kësaj pjese të Fjalëmirës ka vend për qindra faqe udhëzime, por edhe me kaq, vlera e saj është plotësisht e kuptueshme.

3. E ndara me emrin Prushi i Përjetësisë është ndoshta pjesa më origjinale e këtij projekti. Dihet që të gjithë njerëzit vdesin, por unë nuk kam qejf ta përdor fjalën vdekje. Në të 2 muret anësorë të sallës ka rreth 100 kamare të madhësisë 1m kub, ndërtuar në formë raftesh dhe mbyllur me kanate të ornamentuara sa më bukur. Këto kamare janë përkujtimoret familjarëve për çdo pjesëtar që është larguar nga jeta. Secili pjesëtar i familjes që është larguar nga jeta ka aty një arkëz me disa sende ose relikte që konsiderohen të domosdoshme për ta përjetësuar kujtimin e tij: Letërnjoftime e pasaporta, jetëshkrim i shkurtër, dëftesa e diploma shkollimi, dëshmi, dekorata, regjistër veprash apo punësh që ka kryer, album me fotografitë më kryesore, skemë e pemës gjenealogjike dhe vendi i të ndjerit në atë pemë, e gjëra të tjera, përfshirë aty një tufë flokësh dhe shishen me hirin e tij, nëse është djegur.

Cetremonitë dhe mënyrat er varrimit ne shqiptarët i kemi pasur dhe i kemi si mos më keq. Mjafton të shkosh në varrezat e Sharrës apo të Tufinit dhe të del vetja qejfit. Thua: Ç'popull jemi ne që duam t'i nderojmë të vdekurit, shpenzojmë qimet e kokës dhe bëjmë një katrahurë. Mendimi im është që dalëngadalë duhet të fusim në praktikën tone mortore ritin e djegies. Trupi i asnjërit prej nesh nuk ka vlerë më të madhe se trupi i Hektorit. Le të ketë një crematorium modern dhe le të kryhet aty puna në mënyrën më dinjitoze të mundshme dhe le të ruhet prej të ndjerit një enë me hi, si kujtim i përjetshëm i tiji. Sa më përket mua, unë do të isha 100 herë më i kënaqur të ma djegin trupin, se sa të më hanë krimbat.

Megjithatë, në Fjalëmirën tone askush nuk do të detyrohet për ta shkelur traditën. Njerëzit le të varrosen sit ë duan e ku të duan, mjafton që ata të sjellin aty sendet e përjetësimit që i përmenda, midis të cilëvet doemos edhe tufën e flokëvet për shkak të AND-së.

Kjo mënyrë procedimi i jep mundësi secilës familje të organizojë përshpirtje e përkujtiore për paraardhësit e vet dhe t'i nderojë ata brez pas brezi, duke mos e humbur asnjëherë lidhjen me rrënjët e veta.

Edhe rreth kësaj pjese të tretë të Fjalëmirës mund të flitet dhe të rrihen mendimet, por thelbi mbetet po ai: Njeriu aty përjetësohet. Nuk i humb gjurma. Nuk i humb emri dhe vetëm kur të përfytyrojmë një periudhë 100 apo 200-vjeçare, na jepet mundësia për ta perceptuar edhe më mire vlerën, jo vetëm të kësaj pjese, port ë krejt këtij projekti.

Vlera e krejt Fjalëmirës së gjuhës shqipe është aq e madhe, sa askush, përveç atij që s'është në gjendje të kuptojë, nuk ka arsye të hezitojë për vënien në jetë të këtij projekti. Mjafton të përfytyrojmë mijëra tragjedi familjare që mund të parandalohen me funksionimin si duhet të këtij INSTITUCIONI. Mjafton të kuptojmë që, me funksionimin si duhet të këtij INSTITUCIONI, mund të parandalohen qindra gjaqe, para se të vijë puna te gjakmarrjet. Qindra mijë fëmijë shqiptarë, që lindin nëpër botë, shpëtohen nga tjetërsimi dhe humbja e identitetit.

Është e kuptueshme që krejt kjo ndërmarrje kërkon një kosto financiare. Por, siç mund të shihet edhe nga sa u tha këtu, përveç një suporti fillestar, krejt puna e Përkujdesjes Gjithshqiptare do të synohet për t'u vetëfinancuar.

Sapo të arrihet për t'u krijuar dfhe pajisur me lejet përkatëse Kryesia e Përkujdeshjes dhe sapo të jetë ndërtuar e para Fjalëmirë në qytetin e Prizrenit, ne do munhd të shkojmë në zvicër, në SGHBA, në Gjermani, në Australi, në Vendet Skandinavë, të hapim atje Fjalëmira pranë shoqatavet ekzistuese dhe ato, përveç rolit që do të luajnë në mjediset e vet, do të mund të shërbejnë edhe si burim financiar për një zgjërim gjithnjë e më frytdhënës.

Unë kam bindjen që këtë project timin do tap resin shqiptarët me shumë shpresa anembanë botës, kudo që jetojnë dhe se Kombi ynë, deri në fund të këtij shekulli do t'ia dale për të ndërtuar dhe për t'i vënë në punë të paktën 150 mijë të këtilla Fjalëmira.

Nuk është, pra, fjala për kurrfarë arnimesh plastikë apo zbukurimesh kozmetikë, por për një mjekim rrënjësor të qindra mijë pjesëtarëve të këtij kombi në të 2 shtetet tanë, si dhe në krejt diasporën tone të vjetër apo të re. Bëhet fjalë për të çelur një rrugë prosperiteti të atillë që ky Komb s'e ka përjetuar kurrë më pare. Klima, tash për tash, është e atillë që këtë punë mund ta bëjmë. Nesër mund të jetë vonë.

Gjokë Dabaj - Janar, 2014

~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~

~ © *Pashtriku.org, 28 Nëntor 2015* ~

~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~